

Vinko Möderndorfer

ROMEO DHE ZHULIETA ISHIN REFUGJATË

Dramë dashurie në dy akte dhe me dy epilogë

Nga sllovenishtja: Nikollë Berishaj

Nuk janë refugjatë vetëm ata që ikin nga lufta. Refugjatë janë të gjithë ata që jetojnë në vendet e veta, por që nuk mund të mbijetojnë me punën e vet. Këta njerëz janë refugjatë brenda popullit të vet, në mesin e njerëzve të vetë, në sistemin që i ka shfrytëzuar dhe hedhur, ndonëse ishin pjesë e rëndësishme e sistemit. Jetojmë në kohën e ikjes globale. Jemi të bindur se refugjatë janë të tjerët, por në të vërtetë jemi ne ata.

PERSONAZHET:

ROMANI

JUNA

I PARI

I DYTË

I TRETË

SEKRETARJA

Personazhet më poshtë mund t'i luajnë katër aktorë

POLICI

POLICI ME QEN

MOTRA

NËNA

BABA

ZËRI NGA ALTOPARLANTI

INFERMIERJA

DASHNORJA

ZYRTARI I BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

PËRKTHYESI

BABA I JUNËS DHE MOTRËS

SKENA – HAPËSIRA E SKENËS

Paraqitjet skenike duhet të ndryshohen shpejt. Assesi nuk bëhet fjalë për hapësira realiste, por për stilizim atmosferik. Në të vërtetë, hapësira e skenës le të jetë e zbrazët. Dy karrige, tryeza, shtrati, karroca e fëmijëve, televizori ... dhe *ndryshimet e dritës*. Hapësirat skenike janë të përshkruara në tekst me më shumë detaje realiste (me qëllim të parafytyrimit më të lehtë) seç duhet të shihen në skenë. Bëhet fjalë për *teatrin mundi (teatrin e botës)*. Hapësira e zbrazët, që me shenja të qarta dhe të stilizuara skenike do të thotë gjithçka (e gjithë bota).

Skenografisë duhet t'i ndihmojnë projeksionet. Me projeksionet bardhë – zi gjithandej ku paraqiten më shumë njerëz (turma). Le të jenë këto projeksione bardhë-zi nga bota reale. Në fakt, fotografi, figura dokumentare, siç i shohim çdo ditë në televizion, në gazeta... Njerëzit që presin para vitrinave në entet e punësimit, njerëzit në sallat e pritjes, radhët e njerëzve para sporteleve, fotografi të njerëzve, që presin në terr para vendndalimeve në autostradë, pamja e kamionit të mbyllur që transporton mish, pamje të njerëzve në rrugë, njerëzit e pastrehë nëpër banka në park... etj. Gjitha këto do t'i japin tekstit atmosferë të posaçme dokumentare, e njëkohësisht do të ndihmojnë për ndryshimet e shpejta të hapësirave dhe atmosferës skenike.

Pikërisht për këtë shkak pamjet skenike para çdo tabloje do të përshkruhet me fjalën *pamje*: *Pamja e zyrës, pamja e sallës së pritjes, pamja e dhomës, pamja e vendndalimit pranë autostradës, pamja e parkut etj., etj.*

AKTI I PARË

SKENA E PARË

Pamja e zyrës.

Në zyrë: I pari, I dyti dhe I treti. Në rroba të mbyllura. Kollaret rreth qafe. Në qoshe sekretarja. Laptopi i hapur. Shkruan. Në mes të zyrës karrigia. Në karrige Romani. Mbi kokën e tij llamba e neonit.

I pari qëndron pranë Romanit.

I dyti qëndron pranë dritares.

I treti shëtit nëpër dhomë. Bën rrathë përreth Romanit.

Një kohë qetësi.

I PARI

Jeni të lumtur?

Romani nuk di si të përgjigjet.

I PARI

Jeni të lumtur?

ROMANI

Unë?

I DYTË

Ju.

Romani nuk di si të përgjigjet

I PARI

Jeni të lumtur?

ROMANI

Tani?

I PARI

Nuk pyeta *kur*, pyeta *a jeni të lumtur*.

ROMANI

Nganjëherë.

I TRETË

Nuk ka pyetur *kur*, ka pyetur, *a jeni të lumtur*

ROMANI

Jam.

Të gjithë heshtin.

Romani shikon përreth i hutuar.

Romani nuk di , si të përgjigjet.

Romani pyet i trembur.

ROMANI

Nuk jam?

Romani shikon përreth i hutuar.

Të gjithë heshtin.

I PARI

Gënjeni?

ROMANI

Jo.

I TRETË

Pse gënjeni?

ROMANI

Nuk gënjej.

I DYTË

Askurrë?

Romani nuk di si të përgjigjet.

I PARI

Secili njeri gënjen.

I DYTË

Secili.

I TRETË

Vetë është çështja, çfarë janë atë gënjeshtër.

I PARI

Sa fatale.

I DYTË

Sa të dëmshme.

I TRETË

Sa të papërmirësueshme.

I PARI

Pra, çka?

Romani nuk di si të përgjigjet

I PARI

Gënjeni?

ROMANI

Po.

I DYTË

Pse thatë pakë përpara se nuk gënjeni?

ROMANI

Gabova.

I TRETË

Jo. Gënjet.

Të tre qeshin.

Pastaj heshtin

E shikojnë Romanin

I PARI

Ta lëmë këtë.

I pari ia lëshon vendin Të dytës.

I dyti i afrohet Romanit.

I pari fillon të ecë rreth Romanit.

I treti ende qëndron pranë dritares.

Sekretarja shkruan.

I DYTË

Çka keni kundër gejëve?

Romani nuk di si të përgjigjet.

I DYTË

Çka keni kundër gejëve?!

ROMANI

Asgjë.

I TRETË

Pyeti, çka keni kundër gejëve.

ROMANI

Asgjë nuk kam kundër gejëve.

I TRETË

Pyeti, *çka keni kundër gejëve, e jo çka nuk keni.*

ROMANI

Përderisa të më lenë të qetë, nuk më pengojnë.

I PARI

E nëse *nuk u lenë të qetë*, ju keni *diçka* kundër gejëve?

Romani nuk di si të përgjigjet.

I DYTË

Është ashtu?

Romani nuk di si të përgjigjet.

I PARI

Jeni gej?

ROMANI

Jo. Jo!

I PARI

Pederast?

Jo. Jo. Definitivisht jo!!

I DYTË

A nuk mjaftonte të thoshit vetëm një herë *jo*? Pse u duk e nevojshme ta mohoni këtë tri herë: *Jo. Jo. Definitivisht jo!!*

I PARI

Jeni pederast?

Romani nuk di si të përgjigjet.

I TRETË

Ta lëmë këtë.

I treti i afrohet Romanit.

I dyti shkon te dritarja.

I pari fillon të ecë rreth Romanit.

Sekretarja shkruan në laptop.

I TRETË

Çka është demokracia?

Romani nuk di si të përgjigjet.

I TRETË

A u duket se demokracia është sistem i mirë shoqëror?

ROMANI

Po.

I TRETË

Vërtetë?

ROMANI

Po.

I PARË

U zëmë në gënjeshtëri.

I TRETË

Par pranuat se gënjeni.

Romani nuk di si të përgjigjet

I TRETË

Pra: demokracia?

ROMANI

Po, më duket *sistem i mirë shoqëror*.

I TRETË

A vetëm *u duket*, apo jeni vërtetë të bindur?

ROMANI

Jam i bindur.

I pari, I dyti dhe I treti shikojnë njëri tjetrin

I TRETË

Është i bindur.

Të tre zgërdhihen.

Qeshin.

Pastaj heshtin.

I TRETË

A je komunist?

ROMANI

Çka?

I TRETË

Dëgjuat.

I PARI

Dëgjuat mirë.

ROMANI

Nuk më intereson politika.

I TRETË

Për kë do të votoni në zgjedhjet e ardhshme?

ROMANI

Nuk dal në zgjedhje.

Të tre heshtin.

E shikojnë Romanin.

Sekretarja e ndërpre në të shtypurit. Edhe ajo e shikon Romanin.

Romani shikon përreth i hutuar.

Romani nuk di si të përgjigjet.

Romani pyet me zë të dobët.

ROMANI

Po kjo nuk është e obligueshme?

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

Romani shikon përreth i hutuar.

Romani pyet me zë të dobët.

ROMANI

A është e obligueshme?

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

Romani shikon përreth i hutuar.

Romani nuk di si të përgjigjet.

ROMANI

Sepse, nëse është e obligueshme, vërtetë nuk e kam ditë. Nuk lexoj gazeta.

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

I TRETË

Sa vjeçar jeni?

ROMANI

Të gjitha i keni të shkruara.

I TRETË

Sa vjeçar jeni?

ROMANI

Njëzet. U shkruan atje.

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

I PARI

Mjaft për sot.

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

Romani ngrihet.

ROMANI

Mund të shkoj?

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

ROMANI

Mirë u pafshim.

Romani niset.

Të gjithë heshtin.

E përcjellin me shikim.

ROMANI

Ju do të më lajmëroni?

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

Romani largohet

I pari e shikon sekretaren.

I PARI

E shënuat?

Sekretarja shikon në laptop.

Sekretarja lexon.

SEKRETARJA

Nuk është gej. Nuk del në vota. Po të dilte do të votonte komunistët.
Nëntëmbëdhjetë vjeç. Njëzet dfo t'i mbushë më njëzetedy shtator. Gënjen.

I pari dhe I treti tundin me kokë.

DRITAT FIKEN

SKENA E DYTË

Pamja e sallës së pritjes.

Një hapësirë e gjatë. Në njërën anë dritaret prej dyshemeje në tavan. Shumë njerëz qëndrojnë pranë vitrinave dhe në heshtje i shikojnë listat e ngjitura, që i ndriçojnë llambat e neonit. Përmes sallës së pritjes janë bankat e vjetruara dhe disa karrige. Në bankë është ulur Juna. Këmbët e shtrira. Këmbët e zbathura. Atletet e vjetruara të tenisit pranë. Xhinset. Bluza. Një vajzë e re e rëndomtë.

Nga prapaskena vjen Romani.

Duart në xhepa. Kalon ngadalë përbri Junës.

Juna e shikon.

JUNA

Cigare?

Romani ndalet.

ROMANI

Unë?

JUNA

Cigare.

ROMANI

Nuk e pi duhanin.

Juna tund kokën me mirëkuptim.

Romani e shikon.

Juna e shikon.

ROMANI

E pi.

Romani e shikon.

Juna e shikon.

ROMANI

Dhe gënjej.

Romani qeshet.

ROMANI

Më zunë. Pak përpara.

Juna tund kokën me mirëkuptim.

ROMANI

Edhe diçka. Harrova.

Juna tund kokën me mirëkuptim..

Romani e shikon.

Juna e shikon.

JUNA

Aq po më pihet një cigare.

ROMANI

Vërtetë nuk kam.

Juna tund kokën me mirëkuptim..

Romani e shikon.

Juna e shikon.

ROMANI

Ta pyesim dikë? E pastaj e pimë për gjysmë... Secili nga një gjysmë?

JUNA

Në fakt unë nuk e pi. Kot. Po mendoj... e kam ndezur. Një herë. Dy herë. Dhe gjithmonë më ka bërë keq. Ty nuk të bë keq?

ROMANI

Unë epi qëkur i bëra dymbëdhjetë. Kjo do të thotë ...

Romani mendon.

ROMANI

Edhe dy vjet e gjysmë do të bëhen dhjetë vjet.

Juna mendon.

JUNA

Pra, qenke gati njëzet vjeç.

ROMANI

Gati.

Juna mendon.

JUNA

E unë i kam mbushur tetëmbëdhjetë.

Juna mendon

JUNA

Që dy muaj.

Romani e shikon.

Juna e shikon.

JUNA

A ke fituar gjë?

ROMANI

Do të më lajmërojnë.

Romani e shikon.

Juna e shikon.

ROMANI

Shpresoj.

Romani e shikon

Juna e shikon.

ROMANI

E ti?

JUNA

Juna.

ROMANI

Mendova, nëse ke fituar, do të të lajmërojnë ...

JUNA

Për moshën tonë nuk ka asgjë. Juna.

ROMANI

Aha. Roman

JUNA

Përndryshe, mua më quajnë Julka. Por mua nuk më pëlqen. Babës i pëlqente ky emër. Nëna e tij është Julka. Në fakt, ishte. Ka vdekur. Nuk e di se kur. E ndërrova emrin. Jo zyrtarisht, ende, sepse është kjo një procedurë, e edhe duhet paguar. Një herë do ta ndërroj edhe zyrtarisht. Mjaft gjatë kam menduar ... *Vetëm jo Julka*, thash, gjithçka tjetër mundet, por *Julka vërtetë jo!* Do të mund të isha Zhulietë. Kështu më quanin në shkollë. Edhe mua më pëlqente. Një mësuese më thërriste ashtu. Mësuesja e sllovenishtes. Më donte. Sepse i shkruaja hartimet e mira. Pa presje, pa pikëçuditësë dhe gjëra të ngjashme, por *gjithmonë me përmbajtje super*, thoshte. Në gramatikë gjithmonë e kisha të dobët, ndërsa në përmbajtje pesëshe. Pesë plus! Në fund gjithmonë e nxirrja një notë pozitive. Gjithmonë. Për shkak të përmbajtjes. E, pra, kjo mësuese më thoshte se jam Zhulietë. Si Zhulieta. Nuk e di, ndoshta ajo ishte lezbike. Nuk e kam idenë. Me siguri ishte lezbike. Ashtu më shikonte. Por mua më pëlqen më shumë Juna. Dashnori i parë. Ndoshta nuk ishte i pari. Ndoshta edhe po. Dashnor *i vërtetë*, po ishte i pari. *I vërtetë*, them, ngase fjetëm bashkë. Bëmë seks. Ka kohë nga kjo. Juna.

ROMANI

Roman.

JUNA

E dëgjova, po.

Romani e shikon.

Juna e shikon.

ROMANI

Juna! Emër i bukur.

JUNA

Të pëlqen?

ROMANI

Edhe Zhulietë do të ishte në rregull.

JUNA

Tepër nobël, thoshte dashnori im. *Zhulietë, Zhulietë! sikur të mendjemadhoheshe*, thoshte. *Juna* i dukej krejt super.

Romani e shikon.

Juna e shikon.

ROMANI

Ke pasur shumë dashnorë?

Juna mendon.

Juna i tregon dhjetë gishtat.

Pastaj edhe dy tjerë.

JUNA

Por, nuk ishin të gjithë të vërtetë. I vërtetë ishte vetëm njëri. Isha e dashuruar. E ai nuk ishte. Krejt isha trullosur, e tillë isha! Ika nga shtëpia, e tillë isha. E ai jo.

Juna rrudh me supe.

Romani tund kokën me mirëkuptim.

JUNA

Po ti?

ROMANI

Çka?

JUNA

Sa?

Romani mendon

ROMANI

Shumë. Nuk më kujtohet sa shumë.

JUNA

Të vërteta?

ROMANI

Sa e sa të vërteta. Shumë të vërteta.

JUNA

A ke qenë i dashuruar?

ROMANI

Sa e sa herë.

Romani e shikon.

Juna e shikon

JUNA

Ku po shkon tani?

ROMANI

Jashtë.

JUNA

Majtas, apo djathtas?

Romani shikon drejt daljes.

Romani mendon.

ROMANI

Po ti? Kah? Majtas apo djathtas?

JUNA

Unë pyeta e para.

Romani shikon drejt daljes.

Romai mendon.

ROMANI

Majtas.

JUNA

Super! Edhe unë.

Juna i mbath atletet e vjetruara për tenis dhe ngritët.

JUNA

A mund të shkojmë bashkë.

Dalin nga salla e pritjes.

Pamje e njerëzve të rinj, që hyjnë pranë vitrinave dhe në heshtje shikojnë listat, të cilat i shndritin dritat e neonit.

DRITAT FIKEN

SKENA E TRETË

Pamja e parkut.

Natë. Një bankë në park.

Romani dhe Juna në bankë.

Juna është ulur pranë Romanit.

Po mundohen me puthje.

Nuk u ka sukses.

Ndalojnë.

Pushojnë një kohë.

Të dihatur.

JUNA

S'ka gjë.

Pushojnë një kohë.

Provojnë përsëri.

Nuk kanë sukses.

Nuk kanë sukses.

Ndalojnë.

JUNA

Është e sikletshme.

ROMANI

Po.

JUNA

Në të fortë është e sikletshme.

ROMANI

Po.

JUNA

Banka po mi gërvishtë gjunjët.

ROMANI

Po.

JUNA

E në shtrat do të ishte super.

ROMANI

Te ti?

JUNA

Nuk ka vend. Motra e ka foshnjën. Dhe gjithmonë janë në shtëpi.

Pushojnë një kohë.

Provojnë përsëri.

Nuk u ka sukses.

Nuk u ka sukses.

Ndalojnë.

ROMANI

Nuk ka kuptim.

JUNA

Jam unë fajtores?

ROMANI

Jo, jo! Aspak!!

JUNA

Po te ti?

ROMANI

Nuk e di. Ndoshta.

JUNA

A je larg?

ROMANI

Një gjysmë ore këmbë. Me autobus disa minuta.

JUNA

Shkojmë këmbë?

ROMANI

Baba është ...

JUNA

Çka?

ROMANI

Është nervoz. Që kur ka vdekur nëna ...

JUNA

Të ka vdekur nëna?

ROMANI

Tash...

Romani mendon.

ROMANI

Gati një gjysmë viti. Me trembëdhjet do të bëhet një gjysmë viti.

Heshtin.

JUNA

A shprehen ngushëllimet pas një gjysmë viti?

ROMANI

Nuk e di.

JUNA

Ngushëllime.

ROMANI

Faleminderit.

Heshtin

JUNA

Dhe?

ROMANI

Dhe çka?

JUNA

Baba yt...

ROMANI

Po. Është nervoz. Nuk dëshiron të sjell dikë. Natën nuk mund të flejë dhe rri në kuzhinë ...

Heshtin.

ROMANI

E ku i ke çua vajzat tua, pra?

Heshtin.

ROMANI

Nuk i kam çua.

Heshtin.

Juna është ulur mbi Romanin.

Heshtin.

JUNA

Tani do ta pija një cigare.

ROMANI

Ti nuk e pi.

JUNA

Kështu thuhet. Pas seksit konvenon cigarja.

Heshtin.

JUNA

Ne nuk bëmë seks.

Heshtin.

JUNA

Do të ta thith?

Heshtin.

JUNA

Do të ta thith.

ROMANI

Nuk do të ndihmojë.

JUNA

Do të shohësh.

Juna ngrihet.

Romani është ende ulur.

Juna gjunjëzohet ndërmjet këmbëve të Romanit.

Fillon.

Fillon.

Rrezja.

Një rreze shndrit nga shkurret drejt në Romanin dhe Junën.

Juna ngrihet shpejt.

Romani ngrihet shpejt. I ngrit pantallonat.

Nga shkurret paraqitet polici me qen.

POLICI

Çka po bëni?

POLICI ME QEN

Po mblidhni lule.

POLICI

Ashtu mu duk.

Policët qeshin.

Qeni leh.

Romani e përqafton Junën rreth qafe.

Policët ndalojnë së qeshuri.

POLICI

Edhe?

ROMANI

Po flisnim.

POLICI ME QEN

A, kështu quhet kjo sot?

Policët qeshin.

Qeni leh.

Romani e shtrëngon edhe më shumë Junën në përqaftimin e vet.

Policët ndalojnë së qeshuri.

POLICI

Dokumentet.

Romani e fut dorën në xhep. Ia dorëzon librezën policit.

POLICI

Ç' është kjo?

ROMANI

Dokument.

POLICI

Letërnjoftimi?

ROMANI

E kam humbur. Jam duke pritur tjetrën.

Polici ia tregon librezën Policit me qen.

POLICI ME QEN

Kjo nuk vlen. Është pa fotografi. E si të di unë, se ky dokument është i yti?

ROMANI

Është librezë e punës.

Polici e shfleton.

POLICI

Asgjë nuk ka brenda.

ROMANI

Emrin, mbiemrin dhe adresën.

POLICI ME QEN

E si ta di unë, se je vërtetë ky? Dhe se vërtetë këto janë të dhënat tuaja.

Polici kthehet drejt Junës.

POLICI

Po ti?

JUNA

Nuk i kam.

POLICI ME QEN

Çka?

JUNA

Nuk i kam me vete. Po mendoj. Letërnjoftimin nuk e kam me vete.

POLICI

Bukur.

ROMANI

Është e dashura ime.

Juna e shikon Romanit.

Romani e shikon Junën.

ROMANI

Unë garantoj për të.

POLICI

A po?!

POLIC ME QEN

Me librezë të punës? Pa fotografi?

ROMANI

Çfarë faji kemi bërë?

Policët shikojnë njëri – tjetrin.

Policët qeshin.

Qeni leh.

Policët ndalojnë së qeshuri.

POLICI ME QEN

Sjellje e palejueshme në vend publik. Pa dokument personal.

POLICI

Nëse jeni pa dokument të vlefshëm, mund të dënoheni – dënimi është prej katërqind deri në tetëqind e tridhjetë euro.

POLICI ME QEN

Herë dy.

POLICI

Përndryshe, si dokument i vlefshëm personal merren: letërnjoftimi, pasaporta, lejekalimi pranëkufitar, patentat e shoferit, leja për armë e madje edhe vërtetimi mbi aftësimin për vozitje të barkave. Asgjë prej këtyre gjërave nuk i keni.

POLICI ME QEN

Këtu është edhe një kundërvajtje.

POLICI

Kush bën marrëdhënie seksuale në vend publik, kush i tregon organet seksuale apo në një mënyrë të dhunshme ofron shërbimet e veta seksuale dhe me atë rast e pengon dike, shkakton shqetësime apo indinjatë të njerëzve, ndëshkohet me dënim prej dyqind e pesëdhjetë deri në pesëqind euro. Edhe sjellja e palejueshme e ka çmimin e vet.

POLICI ME QEN

Herë dy.

POLICI

Gjithçka paguhet.

POLICI ME QEN

Herë dy.

POLICI

Mund të shkoni me ne në stacion.

POLICI ME QEN

Deri në mëngjes. Ta vërtetojmë identitetin.

POLICI

Dhe gjithashtu paguhet. Qëndrimi te ne. Si në hotel.

POLIC ME QEN

Herë dy.

POLICI

Ua heqim nga rroga.

ROMANI

Unë nuk jam në punë.

POLICI

Ne presim. Kur të keni.

POLIC ME QEN

Shteti e merr të veten. Gjithmonë.

Romani shqetësohet.

ROMANI

A nuk keni punë më të mençur! Në vend që të merreni me hajnat, ju po na vërsuleni neve. Turp të keni. Jeni të njëjtë si barabët...

POLICI

Opa! A dëgjova si duhet?

POLICI ME QEN

Ky na tha se jemi *baraba*.

POLICI

Në kohët e përparshme, për këtë do ta fitoje me shkop gome.

POLICI ME QEN

Ndërsa në demokraci për fyerje vetëm dënojmë me para. Sa është kjo?

POLICI

Në pajtim me paragrafin e parët të nenit njëqind e nëntë të LPA, që e trajton ofendimin e organit, apo personit zyrtar, që merret si ndërhyrje në dinjitetin e organit, si për shembull në reputacionin e tij, nderin e jashtëm dhe objektiv, emrin e tij të mirë në opinion ... dënohet me dënimin në para prej njëqind deri në katërqind e njëzet euro.

POLICI ME QEN

Dhe ky ishte një ofendim i rëndë. Unë do të propozoja katërqind e njëzet euro.

ROMANI

Kërkoj falje.

POLICI

Me të arsyetim... Le të jetë. Dyqind.

POLICI ME QEN

Dyqind e pesëdhjetë. Sepse ofendimi i dinjitetit tim ishte i rëndë. E për qenin as të mos flasim.

Qeni leh.

POLICI

Mirë, të shkojmë! Në stacionin e policisë do ta konstatojmë identitetin tuaj, të gjitha dënimet do t'i përcaktojmë së bashku ... Pasi që kjo do të na marrë shumë kohë, do t'u duhej të prisni deri në orën tetë të mëngjesit, kur të vinë ndërrimi tjetër.

POLICI ME QEN

Nuk do ta keni mjaft ngrohtë. Por do të jeni në vendin tuaj.

POLICI

Secili në vend të vet.

POLICI ME QEN

Mos të vinë deri te veprimet e pahijshme.

Policët shikojnë njëri tjetrin.

Policët qeshen.

Qeni leh.

Policët a ndalin së qeshuri.

POLICI

Halo, shkojmë!

Polici me qen ndalon.

POLICI ME QEN

Por mund të merremi vesh edhe *ndryshe*.

POLICI

Po, mund të merremi vesh *ndryshe*.

E shikojnë njëri tjetrin.

Qeni lëshon angullimë.

Policët ndalin së qeshuri.

ROMANI

Si?

Polici bën me sy në drejtim të Junës.

POLICI ME QEN

E pamë.

POLICI

Ti di ta thithësh.

POLICI ME QEN

Kjo të shkon hata mirë për goje.

Policët fillojnë të qeshen.

Qeni fillon të lehë.

Policët ndalojnë së qeshuri.

POLICI

Pra?! Si do të merremi vesh?

E shikojnë njëri tjetrin.

Qeni lëshon angullimë

Juna e shikon Romanin

POLICI

Sjellja e pahijshme në vend publik. Pa dokument personal. Ofendimi i organit. Tri kundërvajtje të rënda. Të gjitha së bashku... ta rrumbullakojmë. Njëmijë e dyqind. Nëse e paguani menjëherë.

POLICI ME QEN

Gjithçka paguhet.

POLICI

Herë dy.

Shikojnë njëri tjetrin.

Qeni lëshon angullimë.

Juna ia lëshon dorën Romanit. E shikon policin me qen.

Polici me qen ia lëshon zinxhirët Policit.

POLICI ME QEN

Merre.

Polici e merr qenin. Polici tjetër ngadalë shkon drejt shkurreve. Gjatë rrugës e patentën e pantallonave.

Juna e shikon Romanin.

E shikojnë njëri tjetrin.

Juna shkon drejt shkurreve.

Juna gjunjëzohet para Policit.

Romani i shtrëngon grushtet.

Romani bërtet dhe vrapon drejt shkurreve, e shtyn Junën dhe e qëllon Policin.

Qeni leh egër dhe ulërin.

DRITAT FIKEN

SKENA E KATËRT

Pamja e lokaleve të podrumit të policisë.

Korridori. Dera me rrjetë hekuri. Romani mbahet për hekurash. Në qelinë pranë një mashkull i dehur gërhin në zë. Qelitë tjera përgjatë korridorit janë të zbrazëta. Gypat e prishur të neonit në tavan ndezën e ndalen.

Romani është i frikësuar. I shqetësuar. Në panik. E dridh derën me hekura.

ROMANI

Juna!

Korridori i zbrazët.

Gërhitje.

ROMANI

Juna!

ROMANI

Korridori i zbrazët.

Gërhitje.

ROMANI

Juna! Junaaaaaaaaa!

Korridori i zbrazët.

Gërhitje.

Dëgjohet zëri i heshtur i Junës nga hapësira pranë.

JUNA

Roman...

Romani pëlcet.

ROMANI

Juna! Juna...! A është gjithçka në rregull?

JUNA

Gjithçka është në rregull.

ROMANI

A të kanë bërë gjë? ... Juna!!

JUNA

Jo. Vetëm ...

ROMANI

Po...?

JUNA

Po kam ftohtë.

ROMANI

Kur të dalim jashtë ... Juna ... Do të përqafoj. Do të ngroh.

Korridori i zbrazët.

Gërhitje.

ROMANI

A po më dëgjon? ... Juna!!

Korridori i zbrazët.

Gërhitje.

ROMANI

Juna!!

Dëgjohe zëri i heshtur nga hapësira pranë.

JUNA

Askush deri më sot nuk ma ka thënë një gjë të tillë.

ROMANI

Do të përqafoj. Do të ngroh, Juna!!

Korridori i zbrazët.

Gërhitje.

Dëgjohe zëri in ulët i Junës nga hapësira pranë.

JUNA

Askush nuk është frikësuar për mua.

Korridori i zbrazët.

Gërhitje.

Tingulli i hapjes së derës.

Vjen Polici.

Vjen polici dhe ndal pranë hekurave. E shikon Romanin.

POLICI

Pa dokument personal. Tetëqind e njëzet. Sjellja e palejueshme në publik. Pesëqind. Akti penal: sulmi mbi personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrës së sigurisë publike, sipas paragrafit të të parë të nenit treqind e tre të ligjit penal... Prej tre deri në gjashtë muaj burg dhe pagimi i shpenzimeve të procesit penal. Përafërsisht gjashtëqind. Gjithsejtë dy mi. Nëse e rrumbullakojmë teposhtë.

Polici e shikon Romanin.

Romani e shikon Policin.

ROMANI

Do të shkoj te gazetarët, do të shkoj në televizion, do të shkoj gjithandej...
keqpërdorim i pozitës zyrtare...

Polici e shikon Romanin

Romani e hap derën me rrjet hekuri.

Gërhitje.

POLICI

Mirë, le të jetë. Kësaj herë.

Romani del në korridor.

Polici dhe Romani e shikojnë njëri tjetrin.

Gërhitje.

POLICI

Dhe mos t'u shoh më.

Romani vrapon nga korridori.

ROMANI

Juna!

Polici e mbyll derën e qelisë së zbrazët.

Gërhitje.

DRITAT FIKEN

SKENA E PESTË

Pamja e sallës së pritjes.

Një hapësirë e gjatë. Në njërën anë dritaret prej dysHEMEJE deri në tavan. Në anën e kundërt vitrinat. Pamje e njerëzve të rinj, që qëndrojnë pranë vitrinave dhe në qetësi shikojnë listat e varura, të cilat i shndrisin llambat e neonit.

Në mes të sallës së pritjes janë tryezat e vjetruara dhe disa karrige. Në bankë është i ulur Romani. Juna është shtrirë me kokë në krahë e tij. Atletet e tyre të vjetruara në dysHEME pranë bankës.

JUNA

Dëshiroj ... një palë atlete të reja, që të jenë *nike*. Ashtu, të thjeshta, pa të lidhëse të shqyera. Dëshiroj ...

Juna shikon tavanin.

Mendon.

JUNA

Të zgjohem në mëngjes me diell. Të shkoj me autobus në punë. Jo tepër të vështirë. Një punë të bukur. Me mëngjes në orën dhjetë. Me vajza si unë ... që të mund të bisedoj. Që të mund të jam *mike* me to. Dëshiroj ...

Juna shikon tavanin.

Mendon.

JUNA

Që motra ime me foshnjën e vet të jetë e lumtur dhe ta gjejnë banesën e vet. Që nëna të jetë e lumtur. Dhe që baba të kthehet një herë përfundimisht nga shërimi dhe të jetë i lumtur. Dëshiroj...

Juna shikon tavanin.

Mendon.

JUNA

Një kafe. Një kafe me qumësht. Pa cigare. Sepse gjithmonë më bën keq... Dëshiroj... Verën. Pushimet. Diellin. Livadhin. Lulet. Dëshiroj... ty të dëshiroj.

Juna shikon tavanin.

Mendon.

JUNA

Ty dhe një dhomë. Dhomën time. Shtratin. Dëshiroj...

Juna shikon tavanin.

Mendon.

JUNA

Asgjë tjetër nuk dëshiroj. Ndoshta ... një krehër. Ke krehër?

Romani buzëqesh.

Romani mohon me kokë.

JUNA

Jo, nuk e dëshiroj krehrin. Krehri është dëshirë idiotheske. Dëshiroj ...

Juna shikon tavanin.

Mendon.

JUNA

... një puthje.

Romani e shikon

Pastaj përkulet dhe e puth.

Dëgjojmë zërin në altoparlant...

ZËRI NGA ALTOPARLANTI

Jasmin Horjak, dhoma dy. Jozhica Makuc, dhoma gjashtë. Roman Novak, dhoma tre.

Romani ngrihet.

ZËRI NGA ALTOPARLANTI

Mihael Martinc, dhoma pesë. Gabriella Mushiç, dhoma katër. Fajko Haliloviq, dhoma një. Për bisedë le të përgatiten: Ibro Markiç, Romana Gabrijelçiç, Marko Fink, Sonja Porle dhe Marjan Ceneriq.

Romani qëndron në këmbë.

Juna ulet.

E shikojnë njëri tjetrin.

ZËRI NGA ALTOPARLANTI

Jasmin Horjak, dhoma dy. Jozhica Makuc, dhoma gjashtë. Roman Novak, dhoma tre. Mihael Martinc, dhoma pesë. Gabriella Mushiç, dhoma katër. Fajko Haliloviq, dhoma një. Për bisedë le të përgatiten: Ibro Markiç, Romana Gabrijelçiç, Marko Fink, Sonja Porle dhe Marjan Ceneriq. Të tjerët pritni.

Romani shkon.

Juna e shikon.

DRITAT FIKEN

SKENA E GJASHTË

Pamje e zyrës.

Në zyrë: I Dyti, I Pari dhe I Treti. Në kostume të errëta. Kollaret rreth qafës. Në qosh sekretarja. Laptopi i hapur. Shkruan. Në mes të zyrës karrigia. Në karrige Romani. Mbi kokën e tij llamba e neonit.

I Pari qëndron pranë Romanit.

I Dyti qëndron pranë dritares.

I treti shëtit nëpër dhomë. Bën rrathë përreth Romanit.

I PARI

Po ta gjeni një milion.

Romani e shikon të Parin.

I PARI

Po ta gjeni një milion në bankënota të vogla.

ROMANI

Çka?

I DYTI

E dëgjuat.

I TRETË

Nuk është askush. Vetëm ju jeni. Askush nuk u shikon. Askush nuk u ka parë. Natë e thellë. Keni bërë një xhiro dhe e keni gjetur një milion.

I PARI

Kanavetën.

I TRETË

Dhe në të një milion.

ROMANI

Veç ashtu?

I PARI

Hipotetikisht.

Romani mendon.

Romani mendon.

ROMANI

Do ta ktheja.

I PARI

Kujt?

ROMANI

Nuk e di. Pronarit.

I TRETË

Së pari do ta hapnit.

ROMANI

Po. Së pari do ta hapja.

I DYTË

Veç ashtu? Një kanavetë të panjohur në tokë.

ROMANI

Po.

I DYTË

E çka, nëse është brenda bomba? *Buuuum!* Adio! Bye-bye! Ju dhe firma, që e ruani natën.

ROMANI

Thatë se brenda janë paratë.

I PARI

Hipotetizohet.

I DYTË

Ju nuk e dini se janë paratë brenda. Mund të jetë bombë. Jetojmë në kohën e bombave.

I PARI

Dhe terrorizmit.

ROMANI

Keni pyetur për para. Çka do të bëja nëse ...

I Dytë e ndërpret ashpër.

I DYTË

Mos na shpjegoni se çka u kemi pyetur, sepse saktësisht e dimë se çka u kemi pyetur.

I TRETË

Dëshirojmë t'u ndihmojmë.

I PARI

Hë, pra?!

Romani mendon.

ROMANI

Do të shikoja...

I PARI

Çka?

ROMANI

Në mos ka bombë brenda.

I TRETË

Buuuum! Jeni të vdekur. E hapni kanavetën dhe *buuum!* A nuk i pëlqejnë lajmet? Çdo ditë ndodhin këto gjëra. Na duhet të jemi të kujdesshëm.

I PARI

Apo filmat. Nuk i shikoni?

ROMANI

Ka kohë që nuk kam qenë në kinema.

I PARI

Po televizionin.

ROMANI

Nuk e shikoj.

I TRETË

Plotësisht i përfunduar?

ROMANI

Baba e mbyll. Mendoj televizorin. E mban në dollap. Në kuzhinë ku fli. Dhe e mbyll.

I Pari e ndërpret ashpër.

I PARI

Marrëdhëniet tuaja familjare nuk na interesojnë.

I DYTË

Vazhdo!

I PARI

Hë, pra!?

ROMANI

Paratë do t'ia ktheja pronarit.

I PARI

Pse menduat? Pse ishit në dyshim? *Do t'ia ktheja, nuk do t'ia ktheja?* Ndoshta keni menduar të ikni me to?

ROMANI

Nuk kam menduar. Nuk isha në dyshim.

Të tre heshtin.

E shikojnë Romanin.

Sekretarja ndalon së shkruari. Edhe ajo ia ngul sytë Romanit.

I Dyti afrohet te sekretarja. E merr laptopin e saj dhe e çon deri te Romani. E vendos ashtu që Romani ta shohë ekranin. Edhe të tjerët e shohin. Të gjithë e shohim. Pastaj i dyti e shtyp pullën. Paraqitet fotografia. Romani në fillim të bisedës.

Incizimi:

I Dyri qëndron pranë dritares.

I Pari qëndron Romanit.

Treti shëtiti nëpër dhomë . Bën rrathë përreth Romanit.

I PARI

Po ta gjeni një milion.

Romani e shikon të Parin.

I PARI

Po ta gjeni një milion në bankënota të vogla.

ROMANI

Çka?

I DYTË

E dëgjuat.

I TRETË

Nuk është askush. Vetëm ju jeni. Askush nuk u shikon. Askush nuk u ka parë. Natë e thellë. Keni bërë një xhiro dhe e keni gjetur një milion.

I PARI

Kanavetën.

I TRETË

Dhe në të një milion.

ROMANI

Veç ashtu?

I PARI

Hipotetikiisht.

Romani mendon.

Romani mendon.

ROMANI

Do ta ktheja.

I PARI

Këtu stop!

I Dyti e shtyp stopin.

Fundi i incizimit.

I Dyti ia kthen laptopin sekretares.

I PARI

E patë! Kur thash: *Hipotetikiisht* ...menduat. një kohë të mirë menduat. Nuk përgjigjet menjëherë: *Do ta ktheja*. Keni menduar. Dyshuar.

I TRETË

Një milion! Janë shumë para! Askush nuk di se i kam gjetur. Askush nuk është këtu. Nëse ik me to... vetëm në mëngjes... Janë gjashtë, shtatë orë ... Vetëm atëherë do ta zbulojnë se mungoj, se i kam marrë. E unë do të jam larg: nëse shkoj me automobil dhe vozis gjashtë orë. Kufijtë e hapur. Evropa. Mynih, Romë, Stamboll. Askush nuk do ta dijë se ku jam. Një milion!! Mund ta filloj një jetë të re!

I DYTË

Kështu keni menduar.

ROMANI

Jo.

I PARI

Gënjeni.

I DYTË

Këtë e kemi konstatuar edhe në seancën e përparshme. E kemi të shënuar.

ROMANI

Nuk kam automobil. Nuk do të mund të ikja...

I Tretë duartroket i entuziazmuar.

I TRETË

Ja, e shihni! Keni menduar për këtë mundësi. *Nuk kam automobil, si të ik me një milion, që nuk janë të miat...*

ROMANI

Jo.

I PARI

S'ka problem edhe nëse keni menduar. A keni?

ROMANI

Jo.

I DYTË

Kjo është njerëzore.

I TRETË

Të gjithë do të mendonin. Edhe unë.

I PARI

Keni menduar?

I DYTË

Na e thoni të vërtetën. E vërteta është e rëndësishme. Punëdhënësit i duan punëtorët që e duan të vërtetën. Dashurinë ndaj të vërtetës punëdhënësit e çmojnë mbi të gjitha.

I PARI

Keni menduar?

Romani mendon.

Romani pohon me kokë.

I PARI

Me zë.

I DYTË

Për incizim.

ROMANI

Po.

I Pari e shikon sekretaren.

I PARI

E kemi?

SEKRETARJA

E incizuar.

I pari tund me kokë i kënaqur.

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

I DYTË

Mjafton për sot.

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

Romani ngritët.

ROMANI

Mund të shkoj?

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

ROMANI

Ditën e mirë.

Romani niset.

Të gjithë heshtin. E përcjellin me shikim.

ROMANI

Do të më lajmëroni?

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Romanin.

Romani niset.

I Pari e shikon sekretaren.

I PARI

E keni shkruar?

Sekretarja shikon në laptop.

Sekretarja lexon.

SEKRETARJA

Po të kishte rast do të vidhte. Po të kishte rast do ta vendoste bombën.

I Pari, I Dyti dhe I Treti pohojnë me kokë.

DRITAT FIKEN

SKENA E SHTATË

Pamje e sallës së pritjes.

Një hapësirë e gjatë. Në njërën anë dritaret prej dysHEMEJE deri në tavan. Në anën e kundërt vitrinat. Pamje e njerëzve të rinj, që qëndrojnë pranë vitrinave dhe në qetësi shikojnë listat e varura, të cilat i shndrisin llambat e neonit.

Romani vjen nga prapaskena. Ndalon para bankës, ku kishte qenë e ulur Juna.

Juna nuk është aty.

Romani pret.

ZËRI NGA ALTOPARLANTI

Alesh Koroshec, dhoma dy. Miodrag Pavlković, dhoma gjashtë. Ifeta Sadiku, dhoma tre. Daniel Pavliç, dhoma pesë. Jozhica Pilihi, dhoma katër, Pavel Miheliç, dhoma një. Pjesëmarrësit tjerë të Konkursit për kërkimin e suksesshëm të vendit të punës i lajmërojmë, se grupet për sot e kanë përfunduar punën.

Romani pret.

ZËRI NGA ALTOPARLANTI

Të gjithë kandidatëve të lajmëruar ua tërheqim vëmendjen se konkursi vazhdon nesër në të njëjtën orë. Faleminderit.

Juna paraqitet nga prapaskena.

Ngadalë i afrohet Romanit.

Ndalon para Romanit.

Shikojnë njëri tjetrin.

Romani ngrihet. Ia vë dorën përmbi supe.

Largohen.

Pranë vitrinave pamje të njerëzve të rinj. Në heshtje shikojnë listat e varura, të cilat i ndriçojnë llambat e neonit.

DRITAT FIKEN

SKENA E SHTATË

Pamja e dhomës.

Në dhomë janë dy shtretër dhe karroca e fëmijëve. Dollapi me televizor të vjetër, tryeza e shtyrë në kënd. Karriget. Shihet se dhoma është njëkohësisht dhomë gjumi dhe dhomë dite me një shtrat shtesë. Ndërmjet shtretërve, tryezës dhe karrigeve ka shumë pak hapësirë. Gjithçka është rrëmujë dhe gjëra të vjetra.

Në shtrat rri Motra me foshnjë në dorë.

Foshnja fle.

Pranë saj është ulur Juna.

JUNA

Ai është gjëja më e bukur që më ka ndodhur në jetë.

MOTRA

Këtë e thua gjithmonë.

JUNA

kësaj radhe vërtetë.

MOTRA

Edhe këtë e thua gjithmonë.

JUNA

Ai më do.

MOTRA

Edhe mua ky imi më donte. E shih tani, çka më ka mbetur nga dashuria e tij.

Motra e puth foshnjën e fjetur në duar.

JUNA

Ti e do fort.

MOTRA

Më së shumti në tërë botën.

Motra hesht.

Juna hesht.

MOTRA

Po të mos e kisha do të hidhesha nën tren.

Motra hesht.

Juna hesht.

JUNA

Pra, do të?

MOTRA

Çka?

JUNA

Dalësh në shëtitje.

MOTRA

Kur?

JUNA

Tani.

Motra hesht.

Juna hesht.

MOTRA

Para një gjysmë ore u ktheva nga parku.

JUNA

Është kohë e bukur.

MOTRA

A nuk mundeni te ai?

Juna mohon me kokë.

Motra hesht.

Juna hesht.

JUNA

Dy orë. Të lutem.

MOTRA

Dy orë? Unë këtë përshurrujën e kam fituar brenda gjashtë minutash.

Juna buzëqesh.

Motra buzëqesh.

MOTRA

Ku është?

JUNA

Po poret para shtëpisë.

MOTRA

Por mos të ndodhë vetëm të lodrohet me ty dhe të ikë.

JUNA

Që dy muaj jemi në lidhje.

MOTRA

Dhe ende nuk keni pasur?

JUNA

Po. Në shpejtësi. Në park. Në nënkalimin e hekurudhës, mbrapa në oborr, në pyll mbi qytet, poshtë në korridor...

Motra e ndërpret.

MOTRA

Në rregull.

Motra hesht.

Juna hesht.

JUNA

Do të donim të ishim pak vetëm. Pa frikë. Veç kaq.

MOTRA

E nëna?

JUNA

Të mërkurave ajo pastron deri në mbrëmje.

MOTRA

Të gjitha i ke llogaritur.

Juna buzëqesh.

Motra buzëqesh.

JUNA

Unë e dua.

MOTRA

Kësaj po i frikësohem. Që e do. E ai ty jo.

JUNA

Ky djalosh mua *vërtetë* më do.

MOTRA

A ka emër?

JUNA

Roman.

Motra hesht.

Juna hesht.

MOTRA

Romani dhe Juna

JUNA

Romeo dhe Zhulieta. Si në atë film. Por që Romani nuk është Leonardo di Caprio.

Juna buzëqesh.

JUNA

Është më i bukur.

Motra buzëqesh.

MOTRA

Nëse më kujtohet mirë, përfundimin nuk e kishin fatlum...

JUNA

Ajo ishte vetëm në film. Në jetën reale ata patën gjashtë fëmijë dhe jetuan të gëzuar deri në fundin e ditëve të tyre.

Motra hesht.

Juna hesht.

MOTRA

A punon?

JUNA

Jo.

MOTRA

Shkëlqyeshëm.

JUNA

Do ta gjejë punën. Edhe unë gjithashtu. Pastaj do të kemi para dhe do të kalojmë të jetojmë vetëm.

Motra hesht.

Juna hesht.

Motra shfryn.

MOTRA

Në cilin shtrat dëshironi?

JUNA

A Mundemi në shtratin tënd? Është më i madh.

Motra me foshnje ngrihet. Foshnjën e vë në karrocë. E mbërthen bluzën. Juna e shikon.

MOTRA

Për dy orë?

JUNA

Faleminderit.

MOTRA

Kaloni bukur.

JUNA

Prit. Do ta njoftosh.

MOTRA

Më mirë jo.

JUNA

Do të pëlqente.

MOTRA

Herën tjetër.

Motra largohet.

Juna shkon pas saj.

Dhoma mbetet e zbrazët për një kohë.

Sendet flasin vetë.

Shishja me biberon.

Peshqirët e pastër.

Shpërgënjtë që thahen në karrige.

Ora në mur.

Fotografitë e ngjitura në xhamat e dollapit.

Tapetat e shlyera.

Tepihu i vjetruar.

Juna kthehet.

JUNA

Dy orë.

Pas saj Romani.

I pasigurt dhe i frikësuar shikon përreth.

Juna e mbyll derën me nxitim.

ROMANI

Je e bindur?

JUNA

Shtratin e kemi.

Juna fillon të zhvishet.

I ngutet.

ROMANI

Ajo ishte motra jote?

JUNA

Me foshnje.

ROMANI

Jeton këtu?

JUNA

Ai i saj iku.

Juna zhvishet.

ROMANI

Pse?

Juna qëndron lakuriq para Romanit.

Shikohen.

JUNA

Ti nuk do të ikish?

Shikohen.

ROMANI

Kurrë.

Juna dhe Romani puthen.

Puthen.

Romani zhvishet gjatë puthjes.

Juna i ndihmon.

Puthen.

Dera hapet vrullshëm.

Në derë nëna.

NËNA

Kurvë! Në shkollë *nuk don*, e të kurvërohesh po! Shakë, ti!

JUNA

Nënë!

Juna veshët.

Edhe Romani veshët në shpejtësi.

NËNA

Dhe ti, idiot! A je i vetëdijshëm se nuk i ka ende tetëmbëdhjetë vjet?! Në burg do të çoj!

JUNA

Për dy muaj do t'i mbush.

NËNA

Por nuk i ke! Dhe mos u mbulo para meje! Të kam parë lakuriq, para seç dije se ekziston ndo pak. Bythën ta kam larë, e tani po turpërohesh para meje... Kurvë! Kurvë e mitur! Nuk do të kurvëroheni në banesën time! Ah, jo! Policinë do ta thërras! Do të fus në burg, qurran i mallkuar!

ROMANI

Zonjë...!

NËNA

Unë nuk jam për ty zonjë! Për kurrkënd nuk jam zonjë! Unë di të punoj, të mundohem, për këtë arsye nuk jam zonjë.

JUNA

Nënë, ky është i dashuri im!

NËNA

Qirësi, po! E shoh! Me pantallona në gjunjë. Turp të kesh, po e pallos të miturën!
Policia!! Policia!!

ROMANI

Unë jam i dashuri i saj.

NËNA

Dhe nuk je i vetmi. Një mi i ka pasur. Kurdoherë që është e butë me mua, *mami a do çaj? mami a të dhembin këmbët? mami unë do t'i laj rrobat...* menjëherë e di se pas dite, kur të mos jam këtu, ajo do të qihet si e marrë. Me të parin që do ta takojë.

JUNA

Nënë!

NËNA

Por që sot nuk ia arrite, zonja *këmbëhapur*, të *mërkurave nëna punon*, mendove, *mundohet deri në mbrëmje*, por sot jo, sepse pikërisht sot më thanë *adio*, dhe se *nuk duhet të vish më! kemi më të lira dhe më të reja*, më thanë. Ta prisha pasditen e seksit, a po?! Kurva e vogël!

Juna qan.

JUNA

Nuk është e vërtetë.

Romani i kthehet Junës.

ROMANI

Nuk i ke ende tetëmbëdhjetë?

JUNA

Do t'i mbush. E çka janë dy muaj!

ROMANI

Më the...

NËNA

Dhe gënjen! Dhe vjedh! Dhe kurvërohet! Kush mi merr gjithmonë paratë e vogla nga kuleta, kush? Hajneshë e vogël!

JUNA

Nuk është e vërtetë! Kur fitoj t'i jap të gjitha.

NËNA

Asgjë nuk fiton, gjithë ditën vetëm shtrirë, zonjusha *këmbëhapur*! Ai që rri shtrirë nuk mund të fitojë. Përpos kurvash. Së paku të ishe kurvë e vërtetë, do ta pahuaje elektrikun, do të blije qumësht për foshnje, e jo kështu, të më duhet mua gjithçka, e

shteruar, e munduar, plaku tërë jetën në shërim, vajza e madhe e ngjizur
fatkeqësisht, e vogla pa punë, me këmbë[përpjetë... Kurva!!

ROMANI

Zonjë... Kjo është bija juaj...

NËNA

Nuk jam *zonjë*! Nëse më thua edhe një herë *zonjë*, do të thërmoj si kusinë e
mbeturinave!

ROMANI

Po flisni për bijën tuaj...

NËNA

Bijën? Kjo është bijë?! Është kurvë e jo bijë!

ROMANI

Dhe për të dashurën time!

NËNA

Gjithçka i kam dhënë!! Mendoja, kjo do ta vazhdojë shkollën, hartime të bukura
shkruan, matematika i shkon, e mua nuk më ka shkua askurrë, unë kam mbetur
shtatzënë kur isha ende fëmijë, e do të dëshiroja ta vazhdoja shkollën, po, po!
Shumë dëshiroja ta vazhdoja, por hasa në një kurvar, alkoolik, fill më fryri, pastaj
edhe një herë, prej të gjitha punëve e dëbuan, e tani edhe bija, e mençura, të gjithë
e lavdëronin e unë mendoja, nëse unë nuk ia arrita, do t'ia arrijë ajo, mendoja, nëse
unë nuk pata fat, do të kenë fat bijat e mia, së paku njëra do të ketë sukses. Të dyja
të mençura, të dyja të talentuara! Çfarë vizatimesh bënte që në kopsht fëmijëror, sa
që thosha se do të bëhet artiste, unë nuk munda, e ajo do të mundë! Dhe, çka
fitova?! Një mut. Njësoj. Të qira dhe të braktisura. Pa punë, pa ardhmëri! Shkollën e
braktisi, ia pagova, e ajo *lamtumirë shkollë, të përshurrsha shkollë!* Dhe *bunf* në
shpinë dhe me këmbë përpjetë...

Juna bërtet.

JUNA

Mjaft, nënë!

NËNA

Gjithkujt që e shikon paksa butë kjo i shtrihet. Edhe e madhja gjithashtu! E fryrë. E
hoqën nga puna, menjëherë sa u pa se ishte shtatzënë, e tani i kam unë të gjitha
mbi shpinë. Si përsëritën të gjitha gjërat! Do të vdes. Të vdes!

Nëna ulet në shtrat.

Juna ik nga dhoma.

ROMANI

Zonjë...

NËNA

Nuk mundem më. Nuk mundem më. Nuk mundem më.

Romani del nga dhoma.

Nëna e ulur në shtrat.

Duart si të vdekura i lëshohen pranë trupit.

DRITAT FIKEN

SKENA E TETË

Pamja e rrugës.

Juna vrapon.

Romani vrapon pas saj.

Juna vrapon dhe qan.

Romani e arrin.

Romani e përqafton.

Juna qan.

Puthje si frymëmërrje.

DRITAT FIKEN

SKENA E NËNTË

Pamja e kuzhinës.

Pas tryeze Baba.

Përball tij Romani dhe Juna.

Mbi tryezë llamba.

Në tryezë një shishe birre dhe një gotë.

Baba ka në vete vetëm një kanotiere të shqyer dhe brekët e brendshme të hirta të vjetruara.

Dollapi përball i hapur. Në dollap televizori. Njëfarë reportazhi televiziv. Zëri i gazetarit televiziv mezi dëgjohet.

Romani ia vë dorën Junës mbi supe.

Shikojnë televizionin.

Në ekranin e televizorit shihet autostrada. Pranë autostradës pamja e kamionit të mbyllur, frigoriferit për transportin e mishit. Automobilat kalojnë me shpejtësi.

GAZETARI TELEVIZIV

Për zbulimin raportoi gazeta austriake Kronenzeitung. Kamionin 7,5 tonelatash, në të cilin është mbishkrimi i firmës së pularisë çeke, në rajonin lindor Gradishçanska, jashtë qytetit Parndorf i pari e hetoi punëtori i firmës Asfinag, që kosiste barin pranë autostradës. E pa se nga kamioni rridhte diçka ...

Baba i ktheu gotën me birrë.

BABA

Do tua jepja edhe juve nga një, por i kam vetëm edhe dy shishe në frigorifer.

ROMANI

Nuk ka nevojë.

BABA

Nata është e gjatë.

ROMANI

Do të pimë ujë.

BABA

E ne pensionistët nuk mund të flemë.

Baba e mbush sërish edhe një gjysmë gote dhe e pi me ëndje.

E fshin shkumën përreth buzëve.

E ul gotën.

BABA

Po më pëlqen. Më së shumti nga shishja.

Baba zgërdhihet.

Romani dhe Juna qeshin.

Shikojnë njëri tjetri përkrye tryeze.

Në TV reportazhi. Mezi dëgjohet. Askush nuk e shikon. Askush nuk e dëgjon.

GAZETARI TELEVIZIV

Kur arriti policia, lëngu i trupave në shkatërrim rridhte nga kamioni. Me siguri refugjatët kishin vdekur para seç kishte arritur kamioni në Austri.

BABA

Banesa është njëqind e tetëdhjetë. Elektri njëzetepesë. Mbeturinat shtatë. Uji gjashtëmbëdhjetë. Edhe gazi njëzetepesë. Dimrit pesëdhjetepesë. Nëse i mbyll radiatorët. Nëna dikur i mbyllte. E tani kur ajo s'është më, i harrova dhe pagova tetëdhjetë. Në janar gati njëqind. Kur i mbledh të gjitha, me mbesin vetëm edhe njëzet për tërë muajin. Vetëm për cigare paguaj gjashtëdhjetë, pastaj edhe ndonjë birrë ... Nëse nuk i ruaj, në mes të muajit kaloj në minus.

ROMANI

Do të japim edhe ne të dy.

Baba miraton me kokë.

Shikohen përkrye tryeze.

BABA

Kur ishte edhe nëna, ishte më lehtë. Pensioni i saj invalidor dhe pensioni im ...

ROMANI

Do të japin edhe ne. Thash.

BABA

Kur e fitova pagesën e përcjelljes do të duhej të kursenim. Por shkuam në det. Të kujtohet?

Romani pohon me kokë.

BABA

Shkuam një javë. Mendova *njëzet vjet nuk kishim shkua dhe thash, të shkojmë!* Dhe shkuam. Ti posa e kishe përfunduar shkollën fillore. Gjithçka ia lejuam vetes. Çdo ditë akullore. Dhe shko! Pagesa e përcjelljes. Brenda një jave. Dhjetë akullore, dhoma me shtrat shtesë, një herë sardele, jo, dy herë ... Ja qifsha nënën!

Baba e mbush edhe një çerek gote.

E pi.

Shikohen përkrye tryeze.

BABA

Kur?

ROMANI

Që nga sot e tutje. Këtu në kuzhinë, në divanin tim do të flinim. Ditën do ta çoja pranë murit. Aspak nuk do të pengojë. Besoj se së shpejti do të kalojmë në banesë tonë.

BABA

Kur do të jepni ju?

ROMANI

Posa ta fitojmë punën.

Baba miraton me kokë.

Shikohen përkrye tryeze.

ROMANI

Njëri prej nesh do ta fitojë. Herët a vonë.

JUNA

Mua më kanë premtuar...

Baba miraton me kokë.

Shikohen përkrye tryeze.

ROMANI

Jemi edhe në kurs.

BABA

Çfarë kursi?

ROMANI

Si të kandidojmë me sukses për vendin e punës. Diçka ashtu.

Baba pohon me kokë.

Shikohen përkrye tryeze.

BABA

Kush e paguan?

ROMANI

Çka?

BABA

Kursin.

ROMANI

Program i komunitetit evropian.

JUNA

Shkruan në formularë.

Baba miraton me kokë.

Shikohen përkrye tryeze.

BABA

Dhe, është në rregull?

ROMANI

Kush?

BABA

Komuniteti evropian. Kursi.

ROMANI

Të mësojnë si t'i plotësosh formularët. T'i shkruash lutjet. Si duhet të përgjigjesh në pyetje. Këto gjëra. Të përgatisin.

BABA

Për punë.

ROMANI

Për ta kërkuar punën.

JUNA

Shumë sish vërtetë e fitojnë menjëherë.

Baba miraton me kokë.

Shikohen përkrye tryeze.

Baba papritmas e merr Junën për dore.

Juna shtanget.

BABA

Me nënën mendonim se nuk do të bëhet gjë prej tij.

Shikohen përkrye tryeze.

Baba e mban dorën e Junës. E shtrëngon.

BABA

Mendua se është pederast.

Shikohen përkrye tryeze.

Baba e mban dorën e Junës. E shtrëngon.

BABA

Nëna do të gëzohej po ta shihte. Me këtë farë femre të bukur.

Juna e nxjerr dorën e vet nga shuplaka e madhe e babës.

Shikohen përkrye tryeze.

Shikohen përkrye tryeze.

ROMANI

Pra, mund të jemi bashkë? Nuk do të penglojmë.

BABA

A di të ziejë?

JUNA

Di.

BABA

Nëna dinte të ziente shkëlqyeshëm. Specat e saj të mbushur ishin mbretërorë.

JUNA

Do të mësohem.

Baba pohon me kokë.

Shikohen përkrye tryeze.

Pastaj baba përsëri shikon televizionin. Me telekomandë e rrit zërin.

Në ekranin televiziv shihet autostrada. Automobilat e policisë. Automjeti i ndihmës së shpejtë. Nga kamioni i mbyllur qesin thasë të zezë ... Automobilat shpejtojnë pranë.

UDHËHEQËSI TELEVIZIV

Detajet mbi ngjarjen tragjike nuk janë ende të njohura, hetuesit mendojnë se të gjithë njëzetedy refugjatët ishin asfiksuar. “Jam thellësisht i prekur...” deklaroi ministri i drejtësisë Wolfgang Brandstetter, “kontrabandistat e njerëzve janë kriminelë që u intereson vetëm fitimi i tyre...”

Baba shtyp pullën dhe e fik televizorin. Pastaj ngrihet dhe shkon te dollapi. E merr çelësin nga rafti dhe e mbyll dollapin. Me çelës në dorë largohet nga kuzhina.

BABA

Nëse dëshironi ujë, mbusheni vetë.

Baba e mbyll derën pas vetes.

Romani dhe Juna vetëm në kuzhinë.

DRITAT FIKEN

SKENA E DHJETË

Pamje e livadhit mbi qytet.

Në largësi ndërtesat. Shtëpitë. Kështjella mbi qytet.

Bëhet natë.

Juna dhe Romani të shtrirë në barë.

JUNA

Dhe perdet. Të kuqe. Në dhomën e gjumit të kaltra, si qielli i kaltër. E ti?

ROMANI

Gjithashtu.

JUNA

Çka dëshiron?

ROMANI

Të njëjtën.

JUNA

Çka, të njëjtën?

ROMANI

Perdet. Të kaltra si dielli.

JUNA

Dhe në atë kaltërsi pika të verdha. Si yje. Si qielli i kaltër i shpuar me yje. Këtë e mendove?

ROMANI

Po.

JUNA

Dhe enët. Tenxheret dhe kusitë. Dhe pjatat. Me lule të imëta përreth. I pash një herë dhe më pëlqyen shumë. I thash vetes, *edhe unë do t'i kam të tilla*. Me lule të imëta përreth. E ti?

ROMANI

Gjithashtu.

JUNA

Me lule të imëta përreth?

ROMANI

Ndoshta.

JUNA

A vërtetë nuk ke asnjë dëshirë?

ROMANI

Po, kam.

JUNA

Cilën?

Romani mendon.

JUNA

Çka?

ROMANI

Që ta kemi gjithmonë kështu bukur, siç e kemi sot.

Juna i afrohet edhe më shumë Romanit.

Romani dhe Juna heshtin.

Shikojnë qiellin.

Qielli errësohet.

JUNA.

Mendon se po na përgjon dikush?

ROMANI

Farë perversi.

JUNA

Po mendoj, prej së larti.

Romani mendon

ROMANI

Nuk shkoj në kishë.

JUNA

Nga gjithësia.

ROMANI

Askurrë nuk kemi shkuar në kishë. Ndoshta kjo është e gabuar. Nuk e di.

JUNA

Nga ndonjë botë tjetër. Njerëz tjerë.

ROMANI

Marsianët, mendon.

JUNA

Dhe mendojnë, *shih, si duhen atje poshtë!*

ROMANI

Ose, si urrehen.

JUNA

Mendoj se urrejtja nuk shihet prej aq larg, nga gjithësia. Ndërsa dashuria po.

ROMANI

Pse të mos shihej urrejtja, nëse shihet dashuria?

JUNA

Urrejtja është e errët. Ndërsa dashuria shkëlqen. Për këtë arsye urrejtja nuk shihet në gjithësi, e dashuria po.

ROMANI

Mendon?

JUNA

Jam e sigurt.

Romani qeshet lehtë.

JUNA

Çka, nuk kam të dtejrë?

ROMANI

Nuk e di.

JUNA

Mendon se po i trilloj gjërat?

ROMANI

Jo.

JUNA

E pse qeshesh, pra?

ROMANI

Më duket... Më duket e bukur ajo që the. Por, nuk e di a është e vërtetë.

JUNA

Natyrisht se është e vërtetë! Shiko... Nëse je i zemëruar, nervoz, nëse kërcet me dhëmbë, nëse nuk je i kënaqur... Këtë nuk e sheh askush. Të gjithë shkojnë përpara. Asnjë nuk dëshiron ta shohë këtë. Të gjithë shtiren, se kjo nuk ekziston. Se nuk ekziston fatkeqësia, se nuk ekziston mjerimi, se nuk ka njerëz të humbur, se nuk ekziston vetmia... E nëse je i dashuruar, të shohin. Të shikojnë. Të gjithë e vërejnë dashurinë, sepse dashuria është e ndritshme. Sepse përhap dritën. Sepse shndrit. Madje edhe në planetë tjera e vërejnë. Sepse dashuria shkëlqen nëpër gjithësi. Tani na shikojnë nga distanca të yjeve dhe e dinë se ne duhemi.

Romani e shtrëngon Junën edhe më shumë.

JUNA

Më beson?

ROMANI

Po, shikojnë.

JUNA

Dashurinë tonë.

ROMANI

Pak përpara kur u zhveshëm, e pash se po na shikonte një tullac dhe e bënte me dorë.

Juna shtanget.

Juna ngrihet.

JUNA

Pih! Pse nuk më tregove?!

Romani ngrihet.

Rrudh me supe.

Juna i merr sendet e tyre.

JUNA

Gjithçka prishe.

ROMANI

Unë?

JUNA

Ishte aq bukur.

Juna shikon përreth.

JUNA

A është ende aty?

ROMANI

Posa përfunduar, shkoi. Nuk i ishim më interesant.

JUNA

Shkojmë!

Romani pohon me kokë.

E merr setrën e vet. Vishet.

JUNA

Përpara kur the...

ROMANI

Po?

JUNA

Që ta kemi gjithmonë aq bukur si sot.

Shikohen.

Shikohen.

Qielli errësohet.

Yjet në të shkëlqejnë.

DRITAT FIKEN

SKENA E NJËMBËDHJETË

Pamja e zyrës.

Në zyrë: I pari, I dyti dhe I tretë. Në rroba të mbyllura. Kollaret rreth qafe. Në qosh sekretarja. Laptopi i hapur. Shkruan. Në mes të zyrës karrigia. Në karrige Juna.mbi kokën e saj drita e neonit.

I pari qëndron pranë Junës.

I dyti qëndron pranë dritares.

I tretë shëtit nëpër dhomë. Bën rrethe përreth Junës.

I PARI

Jeni të lumtur?

JUNA

Po.

I PARI

Jeni vërtetë të lumtur, apo vetëm *mendoni* se jeni të lumtur?

JUNA

Jam e lumtur.

I PARI

Pyeta, a jeni vërtetë të lumtur, apo vetëm *mendoni* se jeni?

JUNA

Vërtetë jam e lumtur.

Heshtin. E shikojnë.

Edhe sekretarja pas laptopit e shikon.

I DYTI

A jeni aq të lumtur, sa që kjo u pengon?

Juna hesht.

Mendon.

JUNA

Nuk po e kuptoj pyetjen.

I PARI

A jeni aq të lumtur sa që u pengon të përqendrohemi?

Juna hesht.

Mendon.

JUNA

Nuk po e kuptoj pyetjen.

I TRETI

Lumturia mund të jetë *vërtetë turbullirë.*

I PARI

Pikërisht ashtu.

I DYTI

Lumturia e tepruar e pengon përqendrimin në punë.

Juna hesht.

Mendon.

JUNA

Nuk po ju kuptoj çka po më pyesni.

I PARI

Nuk po të pyesim. Po konstatojmë.

I TRETË

Njeriu i lumtur është njeri i kënaqur.

JUNA

Jam e kënaqur.

I TRETË

Njeriu i lumtur nuk është njeri ambicioz.

I DYTË

Njeriu i lumtur është i qetë. Nuk lëviz. Nuk garon. Vetëm *i lumtur* është.

JUNA

Është e keqe kjo?

I PARI

Ne pyesim.

I DYTË

Ju përgjigjeni.

I TRETË

Nuk është e keqe, por nuk është produktive.

Juna hesht.

Mendon.

JUNA

Nuk e kuptoj.

I PARI

Ne e kuptojmë. Ju vetëm bashkëpunoni.

JUNA

Doni të thoni se duhet të jem e *palumtur*, nëse dua të punoj mirë?

I PARI

Ne pyesim.

I DYTI

Ju përgjigjeni.

I TRETË

Ta lëmë këtë.

JUNA

Jo! Dua të di, çka nuk është në rregull, nëse jam e lumtur?

I TRETË

Të lumtur mund të jeni vetëm atëherë kur dëshironi gjithnjë e më shumë.

I pari kthehet kah I treti.

I PARI

Mos i përgjigj.

I DYTI

Ne shtrojmë pyetje.

JUNA

E unë mendoj se nëse jam e lumtur mund të punoj më shumë dhe më mirë. A është ashtu?

I TRETË

Të lumtur mund të jeni *vetëm atëherë* kur lumturia është rezultat i punës së mirë.

I PARI

Mos i përgjigj.

I TRETË

Jeni të lumtur, nëse u *lavdërojnë* për punë të mirë. Lumturia duhet të jetë produkt i asaj që të jeni të dobishëm. Lumturia nuk ekziston vet për vete. Lumturia është arritje e punës së rëndë dhe të dobishme.

I DYTI

Këtë e pëlqejnë punëdhënësit.

I TRETË

Të lumtur mund të jeni jo vetëm për vete.

I TRETË

Nëse jeni të lumtur veç ashtu. Për vete. Askurrë nuk mund të bëheni punëtore e mirë.

JUNA

Nuk po ju kuptoj. Ma shpjegoni, ju lutem!

I PARI

Përfunduar.

I DYTË

Për sot përfunduar.

I PARI

Do t'u lajmërojmë.

JUNA

Koha ime nuk ka përfunduar. Këtu shkruan se më takojnë dhjetë minuta të shqyrtimit personal.

I PARI

Ne vendosim kur kalon koha.

I DYTË

Do t'u lajmërojmë.

Të gjithë heshtin.

E shikojnë Junën.

JUNA

Ditën e mirë.

Juna shkon.

Të gjithë heshtin. E përcjellin me shikim.

Juna largohet.

I pari dhe I dyti e shikojnë Të tretin.

I PARI

E menderose.

I DYTË

Gati e pate menderos.

I TRETË

Kërkoj falje.

I DYTI

Ne nuk përgjigjemi në pyetje.

I TRETË

Më rrëshqiti.

I DYTI

Ne pyetjet i shtrojmë.

I PARI

Do të më duhet të raportoj.

I TRETË

Më falni.

E shikojnë njëri – tjetrin.

Heshtin.

I DYTI

Le të jetë. Ishte hera e parë.

E shikojnë njëri – tjetrin.

Heshtin.

I pari kthehet kah Sekretarja.

I PARI

A keni shkruar?

Sekretarja pohon.

Sekretarja shikon në laptop.

Lexon çka ka shkruar.

SEKRETARJA

Gjashtë javë. Ndoshta shtatë. Është shtatzënë.

I pari dhe I dyti dhe I treti pohojnë në shenjë kuptimi.

I PARI

Fshije nga lista.

Sekretarja pohon me kokë.

Shtyp pullën.

I DYTË

Ashtu siç është s'do ta marrë askush.

I PARË

Ashtu të lumtur.

Shikojnë njëri-tjetrin.

Qeshen.

Pastaj qetësohen.

SEKRETARJA

E... A ta ftojme edhe në pjesën e dytë?

I PARË

Logjikisht.

SEKRETARJA

Ndonëse nuk ka farë shansi?

I DYTË

Pse të lodhemi ne.

I PARË

Për këtë jemi të subvencionuar.

DRITAT FIKEN

AKTI I DYTË

SKENA E PARË

Pamja e korridorit të gjatë të bardhë.

Pranë murit karriget e bardha.

Juna dhe Romani të ulur.

Romani ia mban duart e saja në të vetat.

Shikohen.

Presin.

ROMANI

Kur isha shtatë vjeç...

Presin.

ROMANI

Shkoja në klasë të parë. I gëzohesha shkollës. Tani e di se i gëzohesha, ngase në shtëpi nuk e kisha bukur. Nëna e baba vazhdimisht ngatërroheshin. Nëna qante dhe më shtrëngonte pranë vetes. Baba më nxirrte nga duart e saj dhe bërtiste se askurrë nuk do të bëhem burrë, nëse mbahem për fustanin e nënës. Ndërsa nëna më thoshte se baba është dreq, se ka femra tjera. Nuk e dija nël anën e kujt të jam, kë të dua më shumë.

Presin.

ROMANI

Dhe kur shkoja në shkollë ... ishte lehtësim për mua. Isha në shkollë. Nuk kishte ngatërresa, as bërtitje. Vetëm të shtunave dhe të dielave. Mirëpo, atëherë i mbyllja veshët dhe mezi prisja të hënën, të shkoj sërish në shkollë.

Presin.

ROMANI

Pastaj erdhi pranvera. Dhe u sëmura. U sëmura keq. Skarlatina. Kisha temperaturë. Me merreshin mendtë. Nëna qante. Baba rrinte i trishtuar pranë shtratit tim. Disa gjërave as që u kujtohem. U zgjova në spital. E dëgjova mjekun të thoshte: *Do të shohim... djaloshi ndoshta edhe shpëton. Ndoshta nuk do të vdesë. Nuk varet gjithçka nga mjekësia.* E kisha krejtësisht njësoj. Nuk dija ç'do të thoshte të vdesë, e çka shpëton, çka është vdekja. Nuk më vinte keq po të vdisja. Më vinte keq vetëm për faktin se të hënën nuk do të shkoja në shkollë.

Presin.

ROMANI

Mirëpo, kur kisha temperaturë të lartë, kur digjesha, pash në ëndërr se po më gëlltisnin flakët, se po kthehesha në një top zjarri... dhe papritmas, asgjë më nuk e kisha njësoj. Krejt qartësisht më kujtohet... *Dua të jetoj*, e dëgjova një zë, sikur në mua fliste dikush tjetër. Dikush që ishte më i vjetër, më i mençur seç isha unë atëbotë. I kisha shtatë vjet. Asgjë nuk dija për jetën. *Dua të shoh se si shkon tutje...* foli zëri brenda meje.

Presin.

ROMANI

Ma futën gjilpërën në kurriz, nga boshti kurrizor e nxorën palcën dhe temperatura doli nga trupi im. *Ishit me fat*, e dëgjova mjekun, *mjekësia ka përparuar, e shëruam*. E unë e dija se kisha shpëtuar vetëm për faktin se ishte dëshira ime. *Dua të shoh se si shkon tutje!*

Presin.

ROMANI

Nuk kisha farë shkakut të posaçëm për të jetuar. E çka është jeta? A është vetëm ngatërresa e përhershme ndërmjet babës dhe nënës ... apo ndoshta edhe diç tjetër?

Presin.

ROMANI

Thjesht dëshiroja të shihja, *si shkon tutje*. Vetëm aq.

Romani hesht.

Juna dhe Romani ende shikojnë njëri-tjetrin.

Ende mbahen për duarsh.

Presin.

Hapat.

Hapa të ashpër, tingëllues të takave të femrave.

Nëpër korridorin e bardhë vjen infermierja.

Ndalon para Junës dhe Romanit.

INFERMIERJA

Jeni ju në rend.

Juna ngrihet.

Shikon Romanin.

Shikon infermieren.

JUNA

Kemi ndërruar mendjen.

Infermierja buzëqesh.

Infermierja largohet.

DRITAT FIKEN

SKENA E DYTË

Pamja e kuzhinës.

Pas tryeze Baba dhe Lubica.

Në anën tjetër të tryezës Romani.

Mbi tryezë ndriçon llamba.

Në tryezë para babës dhe Lubicës një shishe me birrë dhe dy gota.

Baba dhe Lubica gjerbin ngadalë birrën secili nga gota e vet.

Dollapi me televizor i mbyllur.

BABA

Kështu është...

Baba hesht.

Baba e shikon Lubicën.

BABA

Siç është.

Baba hesht.

Baba e shikon Lubicën.

BABA

Lubica tani do të jetë te unë.

Romani pohon me kokë.

ROMANI

Kuptoj.

BABA

Asgjë nuk kupton!

ROMANI

Kuptoj. Lubica tani do të jetë tani këtu. Te ti.

BABA

E ka pensionin. Me dy pensione bashkë do të jetë më lehtë.

LUBICA

Dhe kjo banesë është për *ne të dyve* mjaftueshëm e madhe.

BABA

Rryma elektrike për dy është krejtësisht njësoj si rryma elektrike për një.

LUBICA

Edhe mbeturinat.

BABA

Një herë paguan për dy.

LUBICA

Nëse janë dy, gjithçka është më lirë.

BABA

Një bukë mjafton për dy veta.

LUBICA

Për njërin është tepër. Gjithçka kalon në peshë.

BABA

Është më shëndetshëm. Nëse janë dy.

Të tre heshtin.

Romani i shikon.

Romani i shikon.

LUBICA

Nuk është ajo që mendon.

ROMANI

E, çka mendoj?

BABA

Se isha me Lubicën edhe përpara, kur ishte nëna ende gjallë.

ROMANI

Këtë e dinë të gjithë

Lubica gati qan.

LUBICA

Por nuk ishim!

Baba bërtet panda.

BABA

Nuk ishim!

LUBICA

Njerëzit janë të ligë.

BABA

Qesin fjalë.

LUBICA

Gjithçka trillojnë!

Romani i shikon.

ROMANI

Tash është krejtësisht njësoj.

LUBICA

Isha shoqja më e ngushtë e saj.

ROMANI

Tash është krejtësisht njësoj.

BABA

Nuk është nisoj. Nuk është! Sepse...

Baba hesht.

Baba e mbush një gjysmë gote birrë.

Baba e pi.

ROMANI

Sepse çka?

BABA

Sepse nuk ishim.

LUBICA

U munduam. Por *nuk ishim!*

BABA

Vetëm kur vdiq nëna, atëherë po.

LUBICA

Isha shoqja më e ngushtë e saj.

Të tre heshtin.

Pas një kohe Romani shfryn.

ROMANI

Unë ju pash.

Baba dhe Lubica e shikojnë Romanin.

BABA

Kur?

ROMANI

Nuk ka rëndësi.

LUBICA

Kur?!

ROMANI

Atëherë kur nëna ishte për herë të fundit në spital. Erdha në shtëpi... Më parë se zakonisht. Shkolla nuk punonte.

LUBICA

Nuk e dija.

ROMANI

U dëgjova. Në dhomën e gjumit. Në shtratin e nënës e bëtë.

Të tre heshtin.

BABA

Gjithmonë e lija çelësin në derë.

ROMANI

Atë ditë kishe harruar.

BABA

E pamundshme.

ROMANI

U largova.

LUBICA

Atëherë ndodhi veç një herë. Veç një herë!

ROMANI

Diku poas një ore u ktheva. U shtira se nuk kisha parë. Sikur nuk kisha dëgjuar. Sikur nuk kisha parë.

LUBICA

Më erdhi keq për këtë. Isha shoqja më e mirë e saj.

ROMANI

E kuptoj.

Baba çmendet.

Baba e gjuan shishen për muri.

Shishja thyhet.

Lubica e fsheh fytyrën.

Romani e shikon qetë babën.

BABA

Karin tim ti e kupton! Asgjë nuk kupton!! Nuk e di si ishte. S'e ke idenë. Skëterrë! Tërë me kancer. Duart dhe këmbët i kishte të ënjtura. Gjithçka rridhte prej saj. Nuk e di si ishte. Zieja, por gjithçka më digjej. Hekurosja, por i dogja të gjitha këmishat. Fshija, por kishte gjithnjë e më shumë mbeturina... *Tani do të jesh vetëm*, më tha, se ma dëshironte këtë, *do të shohësh si duket kur je vetëm për gjithçka, do të shohësh*. Ishte e gëzuar se do të vdiste, gëzohej, sepse mendonte se nuk do t'ia dilja. Mendonte se do të cofja. Por jo. As nuk do të cofë!

Lubica e përqafon.

LUBICA

Jo, nuk do të cofësh.

BABA

Nuk e doja. Askurrë nuk e kam dashtë. Kur vdiq, isha i lumtur.

Të tre heshtin.

ROMANI

E kuptoj.

Baba i mërzhitur shikon në tryezë.

Të tre heshtin.

Dera hapet.

Hyn Juna.

Është shtatzënë. Me bark të madh. Deri në mjekër. Muaji i tetë. Në dorë e ka çantën dhe përplot qese plastiku.

Qëndron në prag.

JUNA

Të gjitha i kam.

Romani ngrihet.

JUNA

Mund të shkojmë.

Romani qëndron pranë tryezës.

Shikon babën dhe Lubicën në anën tjetër të tryezës.

Baba i ka zgurdulluar sytë në tryezë. Lubica e pëqafon.

Romani shkon drejt Junës. I merr çantën dhe qeset prej duarve të saj. E merr për dore.

Romani dhe Juna shkojnë.

E mbyllin derën pas vetes.

DRITAT FIKEN

SKENA E TRETË

Pamje e zyrës.

Në zyrë: I pari, I dyti. I treti nuk është më. Në qoshe sekretarja. Laptopi i hapur. Shkruan. Në mes të zyrës karrigia. Në karrige Romani. Mbi kokën e tij llamba e neonit.

I pari qëndron pranë Romanit.

I dyti qëndron pranë dritares.

I PARI

T'i kishit në dispozicion dy vezë të njëjta.

I DYTI

Plotësisht të njëjta.

I PARI

Kuptuat?

Romani tund me kokë.

I PARI

Cilën do ta zgjidhnit?

Romani mendon.

Romani mendon.

ROMANI

Nëse janë të njëjta. A nuk është njësoj?

I DYTË

Ne shtrojmë pyetje.

I PARI

Ju përgjigjeni.

Romani mendon.

Romani mendon.

ROMANI

Nuk e di. Të njëjta janë. Njërën, cilëndo.

I PARI

Prapëseprapë ekziston zgjedhja.

I DYTË

Gjithmonë ka zgjedhje.

I PARI

Cilën, pra?

Romani mendon.

Romani mendon.

ROMANI

Kjo nuk ka farë kuptimi.

I DYTË

Çka nuk ka farë kuptimi?

I PARI

Zgjedhja është me rëndësi.

I DYTË

Zgjedhja ka gjithmonë kuptim.

ROMANI

E tërë *kjo* nuk ka farë kuptimi.

Romani ngrihet.

ROMANI

Më ngutet, më kuptoni?! Më ngutet!

I PARI

Te gjërat aq të rëndësishme nuk duhet të na ngutet.

I DYTI

Nëse na ngutet, do të vendosim gabimisht.

I PARI

Pra, cilën vezë do ta zgjidhnit?

ROMANI

Po kur janë të njëjta! Ashtu thatë!

I DYTI

Cilën?

I PARI

Zgjedhja ekziston.

I DYTI

Vezën e majtë apo të djathtë?

ROMANI

Mua më duhet puna! Më kuptoni?

I PARI

Që përsëri varet nga ajo se ku qëndroni. Në të majtë, apo në të djathtë.

ROMANI

Asgjë tjetër. Dua të punoj. Ta fitoj rrogën. Të kthehem i lodhur në shtëpi. Ta përqafoj gruan. Të kam fëmijë.

I PARI

Nëse qëndroni dhe para vetes keni dy vezë të njëjta, vendimi është a vezën e majtë, a të djathtë varësisht nga pozita e trupit tuaj. E nëse vezët i lini aty ku jnaë dhe silleni rreth tyre, sërish para vetes keni dy vezë të njëjta. Mirëpo, veza paraprakisht e majtë tash është e djathtë dhe anasjelltas.

ROMANI

Nesër do të doja ta çoj fëmijën në kopsht fëmijëror. Ta blej ushqimin. T'i paguaj faturat. Ta pres gruan. Vetëm kaq. Asgjë tjetër. A është kjo tepër?

I PARI

Diçka krejtësisht tjetër është nëse i keni vezët para vetes, por kësaj herë jo vezën e majtë dhe të djathtë, por lart dhe poshtë. Në atë rast zgjedhja është *vezën e lartë apo të poshtme*.

I DYTË

Pra: *të majtën, a të djathtën? Të lartën, a të poshtmen?*

Romani i shikon.

Romani i shikon.

Pastaj kthehet dhe ik.

I DYTË

Do t'u lajmërojmë.

I pari dhe I dyti shikojnë njëri – tjetrin.

I pari dhe i Dyti shikojnë Sekretaren, që ka shënuar gjithçka me kujdes.

I PARI

Keni shënuar?

Sekretarja pohon me kokë.

Sekretarja shikon në laptop.

Lexon çka ka shkruar.

SEKRETARJA

Do ta zgjidhte vezën e majtë. Padyshim.

I pari dhe I dyti pohojnë me kokë si shenjë kuptimi.

DRITAT FIKEN

SKENA E KATËRT

Pamja e rrugës.

Natë.

Para gardhit të lartë nga hekuri një rresht i gjatë i të rinjve që presin.

Romani dhe Juna të ulur në tokë pranë gardhit.

Juna është në shtatzëni të thellë.

*Pranë gardhit nga personi deri te personi lëviz një ZYRTAR
BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND në uniformë dhe PËRKTHYESI i tij. Atyre që
presin u ndajnë formularë me ngjyra të ndryshme. Të kuqë dhe të gjelbër.*

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Füllen Sie das Formular aus, wenn Sie bitte. Wenn unser Büro öffnet, werden Sie früher dran sein.

PËRKTHYESI

Plotësojeni formularin, ju lutem. Kështu, në mëngjes, kur të hapet zyra jonë, do të vini më shpejt në rend.

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Und begrüßen! Deutschland braucht Sie!

PËRKTHYESI

Dhe mirë se erdhët! Gjermanisë i duheni!

Të rinjtë marrin formularët.

I plotësojnë.

Zyrtari BD dhe Përkthyesi i tij vazhdojnë drejt tjetrit që pret.

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Füllen Sie das Formular aus, bitte schön ... MLADENKA

Vielen Dank ...

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Sprechen Sie Deutsch?

E REJA

Ich beenden Deutsch studieren.

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

O! Das ist schön.

E REJA

Ich bin ein Professor für Deutsch und Latein. Tatsächlich, ich ... ich liebe sie deutsche Literatur. Besonders Goethe.

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Das ist sehr schön. Ich liebe Goethe auch. Und Heine. Für Sie diese ein Formular ...
Am Morgen gelten werden, schmelzen sie in der Serie, die mit grüner Farbe
gekennzeichnet ist.

la jep formularin me ngjyrë të gjelbër.

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Und begrüßen! Deutschland braucht Sie!

E REJA

Danke. Sie werden es nicht bereuen

E reja e plotëson formularin.

Zyrtari BD dhe Përkthyesi i tij vazhdojnë te tjetri që pret. Te Romani dhe Juna.

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Füllen Sie das Formular aus, wenn Sie bitte. So wenn unser Büro öffnet,
werden Sie früher dran sein.

PËRKTHYESI

Plotësojeni formularin, ju lutem. Kështu, në mëngjes, kur të hapet zyra jonë,
do të vini më shpejt në rend.

Romani e merr formularin.

ROMANI

Edhe për të dashurën time, ju lutem.

PËRKTHYESI

Auch für seine Freundin.

Zyrtari Bundesrepublik Deutschland e shikon Junën në shtatzëni të thellë.

Zyrtari Bundesrepublik Deutschland buzëqesh njerëzisht

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Mann und Frau? Verheiratet?

PËRKTHYESI

Jeni të martuar?

ROMANI

Po... bashkë jemi.

PËRKTHYESI

Sie sind nicht verheiratet

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Und wenn das Kind geboren wird?

PËRKTHYESI

Kur do të lindni?

JUNA

Për dy javë e kam afatin.

PËRKTHYESI

Sehr bald.

Zyrtari BD biuzëqesh njerëzisht.

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Nizza. Sehr schön.

PËRKTHYESI

Bukur.

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Man könnte denken, es wäre besser, wenn ich für das Kind warte ... und später dann über ein Jahr versuchen, alle drei ... Deutschland wird auch immer freundlich junge Familien.

PËRKTHYESI

Nuk mundet. Në këtë gjendje nuk mundet.

Romani dhe Juna heshtin.

Romani ia kthe formularin zyrtarit BD.

ZYRTARI BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND

Smart Sie entscheiden. Ein Kind braucht Sicherheit. Häusliche Pflege. Das Kind braucht seine Großmutter und Großvater. Auf jeden Fall zählt auf Sie Deutschland. Danke.

PËRKTHYESI

Nuk ka kuptim të prisni deri në mëngjes.

Zyrtari BD dhe Përkthyesi i tij lëvizin drejt tjetri që pret. Romani dhe Juna qëndrojnë edhe pak kohë të hutuar para gardhit të madh të hekurt. Pastaj shkojnë.

DRITAT FIKEN

SKENA E PESTË

Pamja e sallës së pritjes.

Hapësirë e gjatë. Në një rën anë dritaret prej dysHEMEJE deri në tavan. Në anën e kundërt vitrinat. Pamja e njerëzve të rinj që qëndrojnë pranë vitrinave dhe në heshtje shikojnë listat e ekspozuara, të cilat i shndrisin llambat e neonit. Në mes të sallës së pritjes banka të vjetruara dhe disa karrige. Në bankë rri Juna, në shtatzëni të thellë. Veç barku i shihet. Një dorë ndjeshëm i është vendosur në barkun e fryrë. I ka këmbët e shtrira. Të zbathura. Atletet e vjetruara për tenis, pranë.

Juna pret.

ZËRI NGA ALTOPARLANTI

Fatih Begović, dhoma dy. Lerka Koncut, dhoma gjashtë. Ramih Salih, dhoma tre. Bojan Kuntiq, dhoma pesë. Sonja Erzhen, dhoma katër. Irena Novak, dhoma një.

Romani vjen nga prapaskena. Ndalon para bankës, ku është ulur Juna.

Shikojnë njëri – tjetrin.

ZËRI NGA ALTOPARLANTI

Pjesëmarrësit tjerë të Kursit për kërkimin e suksesshëm të vendit të punës i lajmërojmë, se për sot grupet kanë ndërprerë punën.

Juna i mbath atletet e vjetruara të tenisit dhe me shumë kujdes ngrihet. Romani i ndihmon.

ZËRI NGA ALTOPARLANTI

Të gjithë kandidatët e paraqitur i përkujtojmë se *Kursi për kërkimin e suksesshëm të vendit të punës* vazhdon nesër në të njëjtën kohë. Faleminderit.

Romani dhe Juna merrem për dore.

Largohen nga salla e pritjes.

Pamja e njerëzve të rinj, që qëndrojnë pranë vitrinave dhe në heshtje i shikojnë listat, të cilat i shndrit llamba e neonit.

DRITAT FIKEN

SKENA E GJASHTË

Pamja e dhomës.

Në dhomë dy shtretër dhe një karrocë fëmijësh. Pranë karrocës për fëmijë edhe “stalla” për fëmijë pak më të rritur. Shihet se dhoma është njëkohësisht edhe dhomë dite edhe dhomë pritjeje me një shtrat shtesë. Ndërmjet shtretërve, tryezës dhe karrigeve, “stallës” dhe karrocës për fëmijë ka shumë pak hapësirë.

Në shtratin e madh është shtrirë një burrë i veshur dhe palmuç. Ky është baba i Junës dhe Motrës së saj. Fli. I kthyer me fytyrë kah muri. Merr frymë thellë. Kohë pas kohe gërhit pakëz dhe kollitet.

Në tryezë pranë është ulur Motra me fëmijë në kraharor. Fëmija fli.

Juna përkulet mbi karrocën e fëmijëve.

Juna nuk është më shtatzënë.

Në shtratin tjetër është ulur Romani.

JUNA

Ka fjetur.

MOTRA

Më në fund!

JUNA

Djemtë i mundon më shumë. Do të duhej t'i jepje gjinj.

MOTRA

As unë nuk i kam dhënë.

JUNA

Mjekja më tha, se nuk kam qumësht për shkak të stresit. I thash se nuk e kuptoj. Se nuk kam stres. Jam e lumtur. Për herë të parë në jetë jam e lumtur.

Juna e shikon Romanin.

Romani e kap për dore.

MOTRA

Pas qumështit të lopës kanë gjithmonë ngërçe.

JUNA

Vetëm ditën e parë kam pasur qumësht. Pastaj shterova.

MOTRA

Vajzat kanë më pak ngërçe. Djemtë më shumë. Ashtu thonë.

Heshtin.

Motra e përkund vajzën në kraharor.

Juna e shikon foshnjën, që fle nëkarrocë.

Baba i Junës dhe i Motrës fle.

Romani e mban Junën për dore.

Heshtin.

Heshtin.

Baba i Junës dhe Motrës kollitet.

Motra e shikon.

MOTRA

Për herë të parë në jetë dëshirova që baba të binte në recidiv.

JUNA

Mjekët thanë se ka shumë mundësi që nuk do të bjerë. Se është i vendosur.

MOTRA

Nëse fillon të pijë, do t'i duhej përsëri në shërim.

Heshtin.

Heshtin.

ROMANI

Shkova.

JUNA

Prit edhe pak.

ROMANI

Nëse vonoj do të më shlyejnë nga shqyrtimi.

MOTRA

Ashtu e ashtu nuk ka farë dobie.

ROMANI

Ke përparësi nëse vijon kursin.

JUNA

Mua më shlyen.

ROMANI

Përkohësisht.

Heshtin.

ROMANI

Më kanë thënë.

Heshtin.

ROMANI

Se do të përfundojë, do të marrin përsëri në shqyrtim. Ashtu thanë.

MOTRA

Çka të *përfundojë*?

ROMANI

Shtatzënia.

MOTRA

Aha? Mendova, kur të përfundojë fëmija.

JUNA

Si shtatzënë vështirë do ta fitoja punën.

MOTRA

Më fal. Nuk është çështja ime...

Heshtin.

Heshtin.

MOTRA

Jam nervoz. Por, nuk di pse. Fëmijët janë shëndosh. Nuk do të vdesim nga uria. Po, në fakt, do të duhej të jemi të lumtur. O, Jezu Krisht!! Të lumtur!

Heshtin.

Baba i Junës dhe Motrës kollitet përsëri.

MOTRA

Shpresoj të kemi qetësi natën.

Juna ktheht kah Romani.

JUNA

Baba gërhit gjithë natën. Madje edhe shëtit nëpër banesë.

MOTRA

Del të përshurrë çdo pesë minuta.

JUNA

Është i shqetësuar.

ROMANI

A fle këtu?

MOTRA

Te nëna.

JUNA

Gjatë ditës është këtu me ne.

MOTRA

Na duhet ta ruajmë.

JUNA

Nëse është vetëm mund të bjerë në recidiv.

MOTRA

Dhe do t'i duhej sërish në shërim.

Baba kollitet.

JUNA

A fle?

MOTRA

Tërheq me veshë.

Motra kthehet drejt babës që fle. I drejtohet. Me zë. Sikur të ngatërrohej me të.

MOTRA

Babi! Pse nuk fillo përsëri të pish? Do të kishim më shumë hapësirë! Pse gjithmonë vendos mbrapsht? A nuk do të ishte njësoj, sikur të shëroheshe edhe nja një gjysmë viti? Ke pi tridhjetë vjet, pse pikërisht tani vendose të mos pish më? Pse, pra? Pse?! Pikërisht tani kur është turmë. Pas një gjysmë viti do të ishte më mirë. Juna do ta kishte punën. Edhe unë. Pra, babi!! Pse tërë jetën vepron mbrapsht?!

Baba hesht.

Baba nuk kollitet më.

Të gjithë heshtin.

Heshtin.

Papritmas dera çelet.

Hyn nëna.

Në duar i ka dy qese nga shitorja.

Menjëherë ngatërrohet me Romanin.

NËNA

Përsëri je këtu?!

Romani ngrihet.

NËNA

A nuk kupton kur të thotë njeriu, se nuk je i mirëseardhur?

JUNA

Nënë... Ka ardhur ta shohë bebin.

NËNA

Nuk dua që ti të sillesh rreth vajzave të mia.

MOTRA

Nënë, çka po flet!

NËNA

E di se si janë! Vetëm të kenë ku ta fusin. Nëse është problem, edhe motra është e mirë.

JUNA

Nënë...

ROMANI

Zonjë...

Nëna tërbohet.

NËNA

Të kam thënë se nuk jam *zonjë*! Unë jam shërbëtorja juaj! Shërbëtorja juaj. Vajzë për gjithçka. Ajo që sjell paratë, që të mund të rrini dhe të llogotisni. Gjithçka mund të jem. Por, nuk jam as nuk dua të jem zonjë!

Romani e puth Junën

ROMANI

Po shkoj.

Juna e merr për dore.

JUNA

Askund nuk do të shkosh! Ky është fëmija yt!

NËNA

Dhe nipi im.

JUNA

Para së gjithash është fëmija *ynë*!

NËNA

Që e ushqej unë! Të dy nipat e mi ushqej.

JUNA

Kur të dojë mund të vijë të fëmija i vet! Nuk mund t'ia ndalosh!

NËNA

Nuk mundem? Thua se nuk mundem?! E si nuk mundem? Unë paguaj ujin, rrymën, banesën... Si nuk mundem?! Atëherë merrni rraqet tuaja dhe *alo tjetërkund!* Ku shkruan se duhet të jeni këtu?! Se duhet t'u ushqej dhe t'u mbaj?! Dhjetë orë kam pastruar, në katër të mëngjesit jam ngritur, kam punuar aq sa gjithçka rridhte nga unë, ja vetëm këto dy qese i fitova për dhjetë orët e mia, madje jo të plota, dhjetë orë punë pa ndërprerje, dy herë kam dalë në dritare, se mendova se po më bie të fikët, dhe gjithçka që fitova lash në dyqan. Hjetë orë punë për një pako shpërgënj, për qumësht në pluhur, për një konservë fasule, një bukë, gjysmë kilogrami miell... Ku shkruan se duhet t'i bëj të gjitha këto...?! Pas dyzet vjetësh punë! Pas burrit, alkoolikut të trefishtë! Jam e lodhur!!

MOTRA

E ligë je.

Nëna kthet furishëm dhe ia ngjet shpullë në fytyrë vajzës.

NËNA

E ligë? Unë, e ligë? Që nuk dua që të vriteni ndërmjet vetes?! Në një banesë dydhomëshe shtatë njerëz. Si minj gjirizi, që fillojnë të hahen ndërmjet vetes nëse u mungon hapësira. Dhe pastaj qurravecja më thotë se jam e ligë! Sepse nuk dua që edhe dikush të jetë aq i pafat siç jemi ne. Të gjitha këto, të dashurit e mi, i bëj që t'u shtyjë mos ta humbni vullnetin, që të luftoni, që të kundërshtoni! E jo të rrini dhe të ankoheni!

Nëna sërish i kthehet Romanit.

NËNA

Për këtë arsye, marsh jashtë! Për bijat e mia do të kujdesem, por jo edhe për ty!! E ju të dy, bashkë me foshnjën mund t'i paketoni plaçkat tuaja dhe alo, *shkoni* diku tjetër! *Shkoni! Shkoni!!*

Juna bërtet pafuqishëm.

JUNA

Nuk kemi kah të shkojmë!!

NËNA

Nëse është ashtu, atëherë vlejnë rregullat e mia.

Nëna e kap Romanin për dore.

NËNA

Kur t'i sjellësh shpërgënjtë dhe qumështin në pluhur, eja përsëri. Alo, shkojmë, shkojmë!

MOTRA

Nënë, pse e bën këtë?

Romani shkon.

Romani Junës.

ROMANI

Nesër në park. Në bankë. Në dymbëdhjetë.

JUNA

Roman... Të dua.

Nëna e shtynë për dere dhe e mbyll derën pas tij.

NËNA

Me dashuri nuk mund ta ushqesh fëmijën.

Juna qan.

Fëmija në karrocë zgjohej. Fillon të qajë.

Fëmija në kraharonin e motrës zgjohej. Fillon të qajë.

Baba përsëri fillon të kollitet në zë.

DRITAT FIKEN

SKENA E SHTATË

Pamje e parkut.

Romani në bankë.

Shikon para vetes.

Pastaj e sjell qaforen dhe i fut duart në xhepa.

Shtrihet mbi bankë dhe bëhet palmuç.

Si embrioni në bankë në park.

Fillon të bjerë shi.

Bie shi.

Bie shi.

Bie shi fuqishëm.

DRITAT FIKEN

SKENA E TETË

Pamje e parkut.

Ditën.

Në bankë të ulur Romani dhe Juna.

Pranë tyre karroca.

Romani e përkund ngadalë.

JUNA

Me ngjyrë të çelura! Dritë! Kuzhina e verdhë... Jo, ngjyrë portokalli! Kam lexuar... Ngjyra e portokalltë nxit oreksin. E verdhë do të jetë paradhoma. E verdh e çelur. Kur të zgjohesh në mëngjes dhe të futesh në të, të mbulon ngjyra e çelur e verdhë dhe e di se dita do të jetë e bukur... ndërsa dhoma e fëmijëve e kaltër! Për djaloshin tonë e kaltër e çelur. Dhe llambat e verdha gjithandej. Ndërsa dhoma jonë e gjumit...? Hë, pra, çfarë ngjyre do të jetë?!

ROMANI

E bardhë?

Juna zhgënjehet.

JUNA

Jo. E bardha nuk është ngjyrë. Duhet të jetë diçka qetësuese... por jo tepër qetësuese. Se në dhomën e gjumit do të bëjmë edhe gjëra tjera, e jo vetëm të flemë... Aspak nuk do të flemë...

Juna qeshet në zë.

Romani shikon karrocën.

ROMANI

Do ta zgjojme.

Juna ndalon së qeshuri.

Juna e përqafon Romanin.

Si e paramendon?

Romani mendon.

Romani mendon.

ROMANI

Krejt si ti.

JUNA

Nuk mund ta paramendosh krejt si unë, duhet ta kesh edhe ti ndonjë dëshirë tënden.
Pra?!

Vinë policët.

Polici i parë dhe Polici me qen.

Kur Romani dhe Juna i shohin, heshtin.

Polici i parë dhe Polici me qen parakalojnë ngadalë.

Romani i shikon.

Romani e përkund karrocën.

JUNA

Pra!! Çka?!

Romani e shikon

ROMANI

Shtratin.

JUNA

Shtratin?

ROMANI

Dëshiroj një shtrat, në të cilin do të mund të flemë në qetësi.

JUNA

Veç aq?

Romani pohon me kokë.

Romani ngrihet.

E puth Junën.

ROMANI

Po shkoj. Nuk guxoj të vonohem.

JUNA

Çfarë ndjenje ke?

Romani buzëqesh.

ROMANI

Më duket, se do të jetë mirë.

Romani shkon.

JUNA

Do të të pres.

Romani largohet.

Juna epërkund karrocën.

Është e lumtur.

DRITAT FIKEN

SKENA E NËNTË

Pamja e zyrës.

Në zyrë: I pari, I dyti, I tretë nuk është më. Në qosh sekretarja. Laptopi i hapur. Shkruan. Karrigia në mes të zyrës. Në karrige Romani. Mbi kokën e tij llamba e neonit.

I Pari dhe I dyti qëndrojnë.

Romani ndërmjet tyre.

E shikojnë.

Nga lart.

Në mënyrë analitike.

I PARI

Diç kundërmon.

E shikojnë Romanin.

I DYTI

Edhe mua më duket.

I PARI

Në lagështi.

I DYTË

Diçka si bajat.

I PARË

Ndoshta në myk?

I DYTË

Në çorape të pandërruara gjatë.

I PARË

Në myk. Definitivisht.

E shikojnë Romanin.

E shikojnë Romanin.

I DYTË

Kandidat. Pyetje për ju!

I PARË

A u duke se këtu diçka kundërmon?

Romani e shikon Të parin.

I DYTË

Përgjigjuni!

I PARË

Kundërmoni?

Romani e shikon.

I PARË

Kjo është pyetje me rëndësi.

I DYTË

Edhe përgjigjja është e rëndësishme.

Romani e shikon Të dytin.

I PARË

Për punëdhënësin është me rëndësi higjiena.

I DYTË

Kundërmoni, apo nuk kundërmoni?

I PARË

Kjo është pyetja tani.

Romani i shikon.

Herë njërin, herë tjetrin.

I DYTË

Kundërmoni?

I PARË

Edhe një pyetje: Jeni të kënaqur me sistemin shoqëror, pjesë integrale e të cilit jemi?

Romani i shikon.

Herë njërin, herë tjetrin.

I DYTË

Apo, ndoshta, kjo është pyetje tepër e vështirë për ju?

I PARË

Nëse shikojmë arsimimin.

I dyti kthehet drejt Sekretares.

I DYTË

Çfarë, në fakt?

Sekretarja lexon nga laptopi.

SEKRETARJA

Gjimnazi. Klasik.

I PARË

Opa!

I DYTË

Pse nuk keni vazhduar?

I PARË

Do të kishit më shumë mundësi.

Romani i shikon.

Herë njërin, herë tjetrin.

I DYTË

Ndoshta edhe jo.

I PARË

Në sistem jemi të gjithë të barabartë.

I DYTË

Pothuajse.

I pari dhe I dyti buzëqeshin

Qeshen.

Bëhen seriozë.

I PARË

T'i lemë këto.

I DYTË

Përgjigjuni në dy pyetjet e shtruara!

I PARË

Kundërmoni?

I DYTË

A jeni të kënaqur me sistemin shoqëror, pjesë integrale e të cilit jemi?

Romani i shikon.

Herë njërin, herë tjetrin.

I PARË

Shikuar arsimimin tuaj, nuk janë pyetje të vështira.

I DYTË

Përfundimisht nuk janë pyetje të vështira.

Romani i shikon.

Herë njërin, herë tjetrin.

I PARË

Të provojmë në mënyrë tjetër. Analitikisht.

I DYTË

Punëdhënësit e çmojnë frymën analitike të punëmarrësve të vetë.

I PARË

Do të thotë: këtu diçka kundërmon.

I DYTË

Unë nuk kundërmoj.

I dyti i drejtohet Të parit.

I DYTË

Ndoshta kundërmon *ti*?

I PARI

Jo, as unë nuk kundërmoj. Zonjë...?

I pari dhe I dyti kthehen drejt Sekretares.

I PARI

Ndoshta kundërmoni *ju*?

Sekretarja ngrihet.

SEKRETARJA

Jo, unë nuk kundërmoj.

Të tre kthehet kah Romani, që është i ulur në karrige dhe i shikon.

I PARI

Mirëpo, në këtë hapësirë diçka kundërmon. Kush? Çka?

I DYTË

Prej kujt vjen kjo aromë e pakëndshme, kur jemi në dhomë ne të katër? Prej tyre tre nuk kundërmojmë.

I PARI

Kjo quhet analizë.

I DYTË

Këtu mbështetet sistemi ynë shoqëror.

I PARI

Në analizë dhe në pranim. Pra: kundërmoni?

Romani i shikon.

I DYTË

Tregoni të vërtetën. E vërtata çmohet. Nëse kundërmoni, asgjë të keqe. Nuk ta marrim për të madhe. Kurrfarë konstatimi të mëvonshëm. Kurrfarë shpenzimesh të mëvonshme. Nëse kundërmoni, nuk keni ç'të kërkon në industrinë e ushqimit. Kjo është e qartë. Llogari të pastra, miq të mirë.

I PARI

Por, mund të punoni diçka tjetër. Diçka vetmitare. Diçka siç jeni *ju*. Dhe kundërmoni vet për vete.

I DYTË

Në sistemin shoqëror, pjesë integrale e të cilit jemi, për secilin gjendet diçka. Edhe për qelbanikë.

I PARI

Sistem i drejtë.

I DYTË

Pothuajse.

I pari dhe I dyti qeshen.

Edhe Sekretarja qeshet.

Qeshen.

Bëhen seriozë.

I PARI

Vazhdojmë!

I DYTË

Dhe për këtë arsye pyetjet: *A kundërmoni?* Dhe *A jeni të kënaqur me sistemin shoqëror*, pjesë integrale e të cilit jemi? janë pyetje tejet të rëndësishme.

I PARI

Pra: Kundërmoni?

Romani i shikon.

Pastaj ngrihet.

I shikon.

I shikon.

Flet me zë të ulët.

Flet seriozisht.

ROMANI

Pse na bëni të marrë?

I pari dhe I dyti e shikojnë të çuditur njëri- tjetrin.

Edhe Sekretarja çuditet.

ROMANI

Pse na bëni të marrë?

I pari dhe I dyti e shikojnë të çuditur Romanin.

Edhe Sekretarja çuditet.

Edhe ajo e shikon Romanin.

Të treve u vjen të qeshin.

ROMANI

Do të doja të punoj si portier. Të punoj si pastrues i xhamave. Si Roje. Do të doja të punoj si korrier . nuk dua të jam shef. Nuk dua të jam punëdhënës. Nuk dua të jam sundimtar i botës. Nuk kam ambicie që t'u zë vendin tuaj: Çfarëdo vendi në këtë shtet të poshtër. Asnjërin nuk e rrezikoj. Asgjë nuk dua. Vetëm të mbledhë mbeturina. Vetëm ta pastroj mutin tuaj. Vetëm kaq. E ju luani me mua. Më pallosni drejt në tru.

Romani e kap Të parin për qaforeje.

ROMANI

Më pallosni në zemër!

Romani e tërheq të parin për kollareje, e tërheq drejt vetes dhe e shtrëngon edhe më shumë.

ROMANI

Më kupton? Vetë dua të marr frymë! Vetëm kaq!

Romani ia shtrëngon kollaren.

I pari mezi merr frymë.

ROMANI

E ju nuk më lejoni... Të marr frymë!

I pari krejtësisht skuqet në fytyrë.

Mezi merr frymë

Romani ia shtrëngon kollaren.

ROMANI

A kërkoj tepër shumë?

I pari fiton ngjyrën vjollcë në fytyrë.

Mezi merr frymë.

ROMANI

Dua ta paguaj qiranë, rrymën elektrike, ujin, mbeturinat. Dua të blej në dyqanet tuaja, dua që në bankat tuaja të huazoj paratë tuaja të shtrenjta. Dua që tu bëj edhe më të pasur. A kërkoj tepër shumë? U duket se kërkoj tepër shumë?!

I dyti afrohet serioz dhe zyrtarisht.

I DYTË

Kandidat, ju lutëm, futeni arsyen në kërkesat tuaja.

Romani e lëshon Të parin... I pari lëkundet. Dihetet. Romani e kap Të dytin për fyti.

ROMANI

Nuk të vjen turp?!

I DYTË

Veç të mirën ua dëshirojmë!!

ROMANI

Unë ua dua të mirën, e ju më përzgjidhni.

Romani e shtrëngon kollaren rreth fytit të Së dytit.

Edhe i dyti mezi merr frymë.

ROMANI

Por unë nuk jam ngarkesë e derdhur të më përzgjidhni. Të më bashkoni. Të ma bëni sortimin, të më klasifikoni. Të më gjuani. Dhe sërish të më mblidhni në grumbull...

Sekretarja dhe I pari afrohen.

I PARI

Te ne respektohet sundimi i të drejtës.

SEKRETARJA

Sjellja e tillë në Evropë sanksionohet.

Romani e lëshon Të dytin. I dyti lëkundet. Dihetet. Romani i ktheht Sekretares.

Romani niset me kërcënim drejt saj.

Romani bërtet me sa fuqi që ka.

ROMANI

Evropa po pëlçet nëpër të gjithë kamçarët.

SEKRETARJA

Ju nuk do ta ngrini dorë mbi femrën!

Romani ia ngjesh një shpullë.

A nuk u vjen aspak turp?!

Sekretarja kapet për koke dhe bërtet.

SEKRETARJA

Ndihmë!! I ra femrës!!

I pari burrërisht vendoset para Romanit.

I PARI

Çka është tepër, dredhet!

Romani e godet Të parin në fytyrë.

Edhe i dyti tenton t'i kundërvihet Romanit.

I DYTË

Prek këtu nuk shkon më tutje!

Romani e shqelmon të dytin në bark.

I dyti bien për tokë.

Romani e shqelmon.

Romani e shqelmon.

Duket si të donte ta vriste.

Sekretarja bërtet e frikësuar.

SEKRETARJA

Ky është fundi i botës! Ky është fundi i botës!!

DRITAT FIKEN

FUNDI I AKTIT TË DYTË

EPILOGU 1

Pamje parku.

Banka në park.

Juna ulur në bankë.

E veshur me pallton e vjetër të së ëmës.

Pret.

Pret.

Vjen Romani.

I veshur në një setër tejet të shkurtër. Në kokë ka kapelën.

Juna nuk e sheh.

Romani qëndron pas shpinës së saj dhe s shikon.

Romani qëndron pas shpinës së saj dhe s shikon.

Pas një kohe Juna kthehet.

Juna e sheh Romanin.

Juna ngrihet.

E shikojnë njëri – tjetrin.

Romani i afrohet ngadalë.

E shikojnë njëri – tjetrin.

E shikojnë njëri – tjetrin.

Romani ulet.

Juna ulet.

Romani shikon para vetes.

Juna e shikon.

ROMANI

Të kam pritur.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

JUNA

Sa shpejt kaloi.

ROMANI

Mua nuk më ka kaluar shpejt.

Juna e shikon

Romani shikon para vetes.

ROMANI

Kam menduar se do të më shkruash.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

ROMANI

Tre muaj kam menduar se do të vish, se do të më shkruash.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

JUNA

Nuk kam mundur.

ROMANI

Unë të kam shkruar.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

ROMANI

Gjithçka që kam fituar kam shpenzuar në zarfa dhe në pulla postare.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

JUNA

Nuk i kam fituar. Me siguri nëna i ka hedhur.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

JUNA

Kam menduar se nuk po më shkruan, se nuk do që të vi të të vizitoj.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

ROMANI

Të kam thirrur. E Kam gjetur numrin e lokalit në rrugën tuaj. *Pemë dhe perime*. Kam thirrur atje. I kam lutur nëse mund të të thërrasin. U kam treguar ku e keni shtëpinë. Me mernin si të çmendur. Më thanë se të njohin, *po, të njohin, të njohin...* Nuk më ndihmuan. Askush nuk më ndihmoi.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

Heshtin.

Heshtin.

ROMANI

Si është vogëlushi?

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

JUNA

Mirë është.

Romani tund me kokë.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

JUNA

E nënshkrove.

ROMANI

Më thanë se e nënshkrove e para.

JUNA

Nuk e dija çka po nënshkruaj.

ROMANI

Nëse e nënshkruan e ëma...

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

ROMANI

E kam nënshkruar.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

ROMANI

A e duan?

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

ROMANI

Vetëm kjo më mundonte... A e duan.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

JUNA

Nuk e di.

Juna e shikon.

Romani shikon para vetes.

JUNA

Nuk kam shkua ta vizitoj.

Vinë policët.

Polici i parë dhe Polici me qen.

Kur i sheh Romani, menjëherë ngrihet me respekt. E heq kapelën. E shohim se i ka flokët e rralla. Shihet se po i bëhet tullaci.

Juna është ulur.

Romani në këmbë.

Polici i parë dhe Polici me qen parakalojnë ngadalë.

Romani qëndron.

Romani shikon pas tyre.

Ende e ka kapelën në dorë.

Juna e shikon.

Romani kthehet kah ajo.

ROMANI

Kapelën e mbaj... flokët po më bien. Do të jam tullac.

JUNA

Mua më pëlqen.

ROMAI

I humba për tre muaj.

JUNA

Nuk më pengon.

ROMANI

Nervat.

E shikojnë njëri – tjetrin.

Romani përsëri e vë kapelën në kokë.

E shikojnë njëri – tjetrin.

E shikojnë njëri – tjetrin.

JUNA

Isha në spital.

Romani hesht

JUNA

Desha të vdisja.

Juna hesht.

Romani hesht.

JUNA

Kur ma morën. Mi morën të dy. Atë dhe ty. Nuk pata më fuqi.

Juna hesht.

Romani hesht.

JUNA

Nëna më tha, se tjetërkund do ta ketë më mirë. Se, nuk është përgjithmonë. Se, do të mund ta kthej. Kur të rregullohet gjithçka.

Juna qan.

JUNA

Por, kur do të rregullohet gjithçka? Kur?!

Juna qetësohet.

Juna hesht.

Romani hesht.

JUNA

Frikohem se do të rritet pa mua. Pa ne. Se nuk do të dijë... se aspak nuk do të dijë...

Juna hesht.

Romani ulet përsëri në bankë.

Juna hesht.

Romani hesht.

Shikojnë para vetes dhe heshtin.

ROMANI

E kisha vështirë, që nuk erdhe.

Juna hesht.

ROMANI

Isha oi zemëruar. E pastaj jo më.

Juna hesht.

ROMANI

Më mungonte vogëlushi. Pastaj jo më.

Juna hesht.

ROMANI

Tre muaj!

Juna hesht.

ROMANI

Pastaj jo më.

Juna hesht.

Romani hesht.

ROMANI

Gjithçka paguhet. Asgjë nuk fiton gratis. Veçanërisht në burg.

Juna hesht.

Romani hesht.

ROMANI

Paguan me atë që ke. E nëse nuk ke asgjë, paguan gjithashtu.

Juna hesht.

Romani hesht.

ROMANI

Gjithçka kam paguar.

Juna hesht.

Romani hesht.

ROMANI

Askurrë askujt nuk do t'i tregoj se çka...

Romani heshtet.

Romani heshtet.

Juna hesht.

Shikojnë para vetes.

ROMANI

Ma kanë premtuar punën.

Juna hesht.

ROMANI

Nesër shkoj me kamion. Në kamion që transporton mish. Dymbëdhjetë orë vozitje. Në veri. Ata paguajnë. E kur të fitoj do të më heqin nga rroga. Shpenzimet. Një kohë do të paguaj edhe interesin. Sepsde do të ma kreditojnë vozitjen. Edhe për fjetje do të mi heqin. Fillimisht shtretër të përbashkët, pastaj do të jetë ndryshe. Më kanë premtuar. Pas një kohe do të jam në zero dhe i gjithë fitimi do të jetë imi. Në fillim jo. Vetëm njëzet për qind. Më mirë se asgjë.

Juna hesht.

Romani hesht.

Romani shfryn.

ROMANI

Në anën tjetër do te gjendemi Zhulietë. Do të pres,
siç e pret bilbili të dashurën e vet dhe thur folenë ... do të ikim,
e dashur, prej gjithkujt, që armiqësia, urrejtja dhe zemërimi ua
përcakton ditët e jetës: ne do të jemi larg prej tyre. Në mbretërinë tjetër
që dashuria ia jep emrin fisnik...

Juna hesht.

ROMANI

Gjimnazi. Ese për maturë... Romeo dhe Zhulieta ishin refugjatë ...

Romani qeshet.

ROMANI

Kjo është e tëra që ka mbet.

Romani hesht.

Juna e shikon.

JUNA

Kur nisesesh?

ROMANI

Nesër. Në vendpushim... pranë daljes në autostradë. Në orën katër të mëngjesit.

Juna ngrihet.

Juna qëndron.

E shikon.

JUNA

Do të vi të përshëndetem.

Juna ik.

Romani mbetet.

DRITAT FIKEN

EPILOGU 2

Pamje e vendpushimit të kamionëve.

Dalja në autostradë.

Ora katër e mëngjesit.

Natë, ende.

Në mes të kamionëve kamioni i mbyllur që transporton mishin. Në të mbishkrimi në një gjuhë të panjohur.

Një grup njerëzish qëndron në terr.

Pinë duhan dhe presin.

Pikat e vogla që digjen të majave të cigareve kohë pas kohe shndrisin më fuqishëm në terr.

Vjen Juna. Në dorë ka një qese të bardhë plastiku.

Juna shikon përreth.

Kërkon Romanin.

Nga grupi i njerëzve, që në terr presin pas kamionit që transporton mishin, shkëputet një hije dhe i afrohet Junës.

ROMANI

Mendova se nuk do të vish.

Juna buzëqesh.

JUNA

Kësaj radhe erdha.

E shikojnë njëri – tjetrin.

Heshtin.

Juna ia jep qesen.

JUNA

Byrek.

Romani e merr qeset nga duart e saj.

JUNA

Do të kesh uri gjatë rrugës.

ROMANI

Faleminderit.

Shikojnë njëri – tjetrin.

Heshtin.

JUNA

Do të kthehesh?

Romani rrudh me supe.

Shikojnë njëri – tjetrin.

Heshtin

JUNA

Posa ta fitoj punën do të shkoj ta marr vogëlushin. Do ta kthej mbrapa.

Shikojnë njëri – tjetrin.

Shikojnë njëri – tjetrin.

ROMANI

Këtu s'ka gjë.

JUNA

Bashkë do ta bëjmë.

ROMANI

Këtu nuk do të ketë askurrë asgjë.

JUNA

Këtu e kam shtëpinë.

ROMANI

Ajo shtëpi është e thatë.

Shikojnë njëri – tjetrin.

Shikojnë njëri – tjetrin.

JUNA

Nëse kthehesh, nuk do të jetë e thatë.

Motori i kamionit, që transporton mishin, kërcet. Dritat e gjata prekin terrin. Hijet e njerëzve futen mbrapa pas kamionit që transporton mishin.

ROMANI

Po shkoj.

JUNA

Prit edhe pak.

Romani pret edhe pak.

Njerëzit futën mbrapa në kamionin që transporton mishin.

Shikojnë njëri – tjetrin.

Shikojnë njëri – tjetrin.

JUNA

Pse nuk na eci?

Shikojnë njëri – tjetrin.

Shikojnë njëri – tjetrin.

JUNA

E deshëm njëri- tjetrin?! Pse..._!

Shikojnë njëri – tjetrin.

Romani e përqafton.

Të përqaftuar qëndrojnë në terr, që ngadalë shndritet.

Hija e fundit hip në kamionin që transporton mishin.

Kamioni që transporton mishin pret.

Përqaftimin e pret.

Buria e automobilit disa herë me padurim e pret mëngjesin e parë në vendpushimin pranë autostradës.

Romani shkon drejt kamionit, që e transporton mishin dhe futet në të.

Pamje e njerëzve të shumtë që qëndrojnë në kamionin e mbushur përplot, që transporton mishin. Njerëzit shikojnë si memecë para vetes, në moment kur dera e kamionit, që transporton mishin, me rrapëllimë të thekshme mbyllet para syve të tyre.

Kamioni që transporton mishin niset nga vendpushimi dhe futet në komunikacion në autostradë.

Juna vetëm në vendpushim.

Ngrit dorën.

Dora e saj një kohë mbetet në ajër.

I dërgon përshëndetje dikujt që nuk ekziston më.

Pastaj Juna e ul dorën.

Dora varet si e vdekur pranë trupit.

DRITAT FIKEN

FUND